

**VENDIM**  
**Nr. 304, datë 22.5.2024**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PROKURIMIN PUBLIK  
2024–2030 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SAJ 2024–2027**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj 2024–2027, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Agjencia e Prokurimit Publik dhe të gjitha institucionet përgjegjëse të përcaktuara në strategjinë dhe në planin e veprimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**STRATEGJIA KOMBËTARE PËR PROKURIMIN PUBLIK  
2024–2030**

**PLANI I VEPRIMIT 2024–2027**

**HYRJE**

**PJESA E PARË – KONTEKSTI STRATEGJIK**

1. Analiza e situatës

1.1. Kuadri ligjor

1.2. Kuadri institucional

1.3. Vlerësimi i Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023 dhe zbatimi i kuadrit ligjor

2. Vizioni i strategjisë 2024–2030

2.1. Objektivat strategjike

2.2. Indikatorët kryesorë

**PJESA E DYTË – QËLLIMET E POLITIKAVE, OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, MASAT  
IMPLEMENTUESE**

1. Qëllimi i politikës 1 – Procesi i prokurimit publik eficient dhe efektiv

1.1. Objektivi specifik 1 – Përmirësimi i kuadrit ligjor

Masa 1.1.1. Rishikimi i ligjit të prokurimit publik

Masa 1.1.2. Rishikimi i akteve nënligjore në përputhje me ligjin e prokurimeve publike

Masa 1.1.3. Përmirësimi i kuadrit ligjor të koncesioneve dhe PPP-ve

Masa 1.1.4. Miratimi i akteve nënligjore në fushën e koncesioneve dhe partneritetit publik privat

Masa 1.1.5. Përmirësimi i kuadrit nënligjor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë

Masa 1.1.6. Procesi i aderimit në GPA-OBT

1.2. Objektivi specifik 2 – Forcimi i kapaciteteve institucionale

Masa 1.2.1. Trajnimi i stafit

Masa 1.2.2. Forcimi i kapaciteteve të ATRAKO-s

1.3. Objektivi specifik 3 – Përmirësimi i blerjes së përqendruar

Masa 1.3.1. Ngritja e operatorit të blerjes së përqendruar sh.a.

Masa 1.3.2. Përmirësimi i eficiencës së prokurimeve të përqendruara  
1.4. Objektivi specifik 4 – Fuqizimi i kapaciteteve zbatuese  
Masa 1.4.1. Profesionalizimi i funksionit të prokurimit publik  
Masa 1.4.2. Rritja e ndërgjegjësimit  
2. Qëllimi i politikës 2 – Prokurimi i qëndrueshëm dhe inovativ  
2.1. Objektivi specifik 1 – Nxitja e prokurimit të gjelbër dhe social  
Masa 2.1.1. Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me përdorimin e kriterëve mjedisorë dhe sociale  
Masa 2.1.2. Trajnime dhe materiale ndihmëse  
2.2. Objektivi specifik 2 – Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik  
Masa 2.2.1. Përmirësime të bazës ligjore  
Masa 2.2.2. Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik  
3. Qëllimi i politikës 3 – Integriteti dhe ligjshmëria e procesit të prokurimeve publike  
3.1. Objektivi specifik 1 – Sigurimi i integritetit në procesin e prokurimit publik  
Masa 3.1.1. Organizimi i eventeve ndërgjegjësuese  
Masa 3.1.2. Përgatitja e materialeve për rritjen e ndërgjegjësimit  
Masa 3.1.3. Bashkëpunimi ndërinstytucional për luftën kundër korrupsionit  
3.2. Objektivi specifik 2 – Siguria ligjore e shqyrtimit të ankesave  
Masa 3.2.1. Rritja e kapaciteteve institucionale për shqyrtimin e ankesave  
Masa 3.2.2. Ndërlidhja e sistemit elektronik të ankesave me sistemin e prokurimit elektronik  
3.3. Objektivi specifik 3 – Forcimi i mekanizmave kontrollues  
Masa 3.3.1. Asistenca paraprake e autoriteteve kontraktore  
Masa 3.3.2. Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik  
Masa 3.3.3. Monitorimi i ekzekutimit të kontratave

## PJESA E TRETË – ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE KOORDINIMI

### 3.1. Përgjegjësia institucionale

#### 3.1. Monitorimi dhe raportimi

## PJESA E KATËRT – PLANI I VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM

Aneksi 1 – Plani i veprimit

Aneksi 2 – Pasaporta e indikatorëve

### Shkurtime

APP – Agjencia e Prokurimit Publik

AK – Autoritet Kontraktor

OE – Operator Ekonomik

ATRAKO – Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve

KPP – Komisioni i Prokurimit Publik

PBB – Produkti i Brendshëm bruto

PKIE – Plani Kombëtar i Integritetit Evropian

IA – Inteligjenca Artificiale

ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

DAP – Departamenti i Administratës Publike

OBP – Operatori i Blerjeve të Përqendruara

VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave

KE – Komisioni Evropian

EBRD – Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BE – Bashkimi Evropian

OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

## HYRJE

Prokurimi Publik i referohet procesit në të cilin autoritetet/entet kontraktore blejnë mallra, punë ose shërbime nga operatorët ekonomikë. Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 përfaqëson dokumentin themelor strategjik dhe merr parasysh kuadrin ligjor ekzistues dhe atë të pritshëm në përputhje me objektivat që duhen përmbushur për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Vizioni ynë 2030 është garantimi i zbatimit të rregullave të legjislacionit në fushën e prokurimit publik. Në këto kushte, prioritetet mbetet respektimi i parimeve, të tilla si mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë, mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive, rritja e transparencës etj., të ndërlidhura me luftën kundër korrupsionit, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit dhe konsumatorit etj.

Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 është në koherencë të plotë me objektivat ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm, me kuadrin ligjor të BE-së në këtë fushë, si edhe me angazhimet e ndërmarra nga pala shqiptare në takimet e përbashkëta me palën evropiane etj.

Procesi i hartimit të strategjisë, i mbështetur nga asistenca teknike e SIGMA-OECD, ka reflektuar edhe iniciativa të nisura dhe jo të finalizuara, pjesë e Strategjisë së Prokurimit Publik 2020–2023, si dhe detyrimet në kuadër të procesit të integritetit dhe sidomos rekomandimet e BE-së të dala nga procesi *Screening*. Ndërkaq, procesi i hartimit të kësaj strategjie është karakterizuar nga pjesëmarrja aktive e specialistëve të prokurimit publik, ekspertëve të fushës dhe grupeve të tjera të interesit, të cilët kanë kontribuar në arritjen e një shkalle të lartë të pajtueshmërisë me prioritetet strategjike dhe mënyrat për trajtimin e tyre.

Procesi i hartimit është organizuar në disa faza, duke përfshirë ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë, konsultime paraprake për metodologjinë e punës dhe formatin e strategjisë, analizën e situatës, e cila ka rezultuar me identifikimin e problematikave në fushën e prokurimeve publike që do të trajtohen nga strategjia; përcaktimin e veprimtarive kryesore dhe masave të strategjisë; hartimin e planit të zbatimit dhe kostimit të strategjisë, konsultimin publik dhe finalizimin e dokumentit.

Ky dokument strategjik vjen në vijim të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023 (SKPP 2020–2023), e cila parashikonte një sërë objektivash strategjike të detajuar me masa konkrete, në realizimin e të cilave u angazhuan institucione publike direkt të përfshira ose kontribuese.

Qëllimi kryesor i kësaj strategjie është garantimi i një sistemi prokurimi eficient dhe efektiv në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar dhe nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para.

Viti 2023 ishte viti i fundit i zbatimit të strategjisë së mëparshme dhe planit të saj të veprimit. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur zhvillime në të gjitha qëllimet e politikave të strategjisë dhe në përgjithësi ka pasur ecuri pozitive. Megjithatë, vijon të ketë aktivitete në proces realizimi apo aktivitete që duhet të realizohen, të cilat do të materializohen dhe të reflektohen në SKPP 2024–2030. Për këtë arsye, edhe SKPP 2024–2030 do të reflektojë ato objektiva specifike dhe masa të cilat do të synohen të realizohen gjatë viteve të ardhshme.

Në fokus të SKPP 2024–2030, ndër të tjera, përmendim rritjen e eficiencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik; mirëpërdorimin e fondeve publike dhe reduktimin e shpenzimeve procedurale; nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, sidomos promovimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve të vogla e të mesme (SME); nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë; sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; garantimin e integritetit, rritjen e besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

## PJESA E PARË KONTEKSTI STRATEGJIK

Prokurimi publik është një fushë e rëndësishme të grup-kapitulli 1 “Themelorët” në metodologjinë e BE-së. Parashikimet mbi procesin e prokurimit publik dhe kontratat zënë një vend të posaçëm në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Zbatimi me korrektësi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), përmbushja e detyrimeve dhe adresimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian edhe në fushën e prokurimeve publike janë elemente kryesore në procesin e aderimit të Shqipërisë në BE.

Këshilli Evropian, më 26 mars 2020, miratoi vendimin e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së për hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe në nëntor të vitit 2022 u zhvillua takimi dypalësh për kapitullin 5 “Prokurimi publik”, në kuadër të procesit *Screening*, ku pala evropiane theksoi se legjislacioni shqiptar në fushën e prokurimit publik është në një masë të madhe i përfaruar me *acquis* e BE-së.

Prokurimi publik është një nga fushat kryesore të përfshira edhe në Strategji të tjera Kombëtare e Ndërsektoriale. Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2023, prokurimi është pjesë e qëllimit parësor – Integrimi Evropian, ku theksohet se procesi i prokurimit publik është totalisht i digjitalizuar, i lehtë, i aksesueshëm, transparent në të gjitha fazat e tij, ndërkohë që numri i ankesave është ulur. Gjithashtu, prokurimi publik është pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit dhe Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publike, ku vërehet se në fushën e prokurimit publik janë realizuar plotësisht aktivitetet dhe indikatorët e performancës, në lidhje me këto dokumente strategjike. Gjithashtu, në fushën e prokurimit publik është dhënë kontribut edhe në lidhje me rishikimin e këtyre strategjive dhe hartimin e strategjive e të planeve të reja të veprimit për periudhën 2024–2030.

Komisioni Evropian në raportin vjetor të vitit 2023 për Shqipërinë sa i takon kapitullit 5 “Prokurimi publik” shprehet se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimet publike.

Në raportin e vlerësimit për reformën në administratën publike për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, të përgatitur nga SIGMA, sistemi i prokurimit publik në Shqipëri ka marrë vlerësimin maksimal 5/5 për 3 nga 5 indikatorë dhe vlerësimin 3/5 për 2 indikatorët e tjerë. Konkretisht, është vlerësuar maksimalisht në lidhje me kapacitetet institucionale në fushën e prokurimit publik në nivel qendror për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në fushën e prokurimit në mënyrë efektive dhe eficiente.

### 1. ANALIZA E SITUATËS

#### 1.1. KUADRI LIGJOR

Prej *vitit 2020*, në fushën e prokurimeve publike është miratuar ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i hyrë në fuqi më 31 mars 2021, i harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian (2014/24, 2014/25 dhe 89/665 EEC, 92/13/EEC mbi mjetet juridike dhe rishikimin administrativ).

Ligji ka sjellë risi për sa i përket aspekteve të rëndësishme, të tilla si:

- qartësimi i fushës së zbatimit, përjashtimeve specifike dhe kontratave të përziera të prokurimit;
- koncepti i kontratave të rezervuara dhe kontratave ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik, njoftimeve paraprake dhe periodike të informacionit, si mjete që rrisin transparencën dhe i japin mundësi operatorëve ekonomikë të njihen kohë më parë me të dhënat e një objekti konkret prokurimi të planifikuar;

- përcaktimi i kufirit të ulët dhe të lartë monetar;
- procedurat e prokurimit, sipas direktivave përkatëse të BE-së, duke parashikuar procedura të reja prokurimi, me faza, siç janë: procedura konkurruese me negocim, dialogu konkurrues dhe partneriteti për inovacion;

- parashikimi i procedurave më të thjeshtuara në prokurimin e veprimtarive të sektorit sektorial me një krye të posaçëm, me rregullime specifike për sektorin sektorial (i cili, përfshin veprimtari që kanë

të bëjnë me shërbimet e transportit, ujit, energjisë, gazit, shërbimet postare, portet dhe aeroportet);

- lehtësimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nëpërmjet përdorimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

- parashikimi i përdorimit të kriterit për vlerësim “oferta ekonomike më e favorshme”, e cila identifikohet në bazë të çmimit dhe kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos;

- paraqitja e sigurimit të ofertës, si një masë mbrojtëse për autoritetet kontraktore, në rast të tërheqjes së ofertuesit;

- koncepti i reduktimit të numrit të operatorëve ekonomikë të kualifikuar në procedurat me faza, nëse një gjë e tillë përcaktohet si mundësi nga autoriteti kontraktor që në dokumentet e tenderit;

- ulja e afatit minimal të periudhës së përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike, duke filluar nga 3 muaj;

- parashikimi i periudhës së pritjes, gjatë së cilës autoriteti kontraktor nuk mund të nënshkruajë kontratë, periudhë e cila fillon nga shpallja e njoftimit të fituesit;

- lehtësia në prokurimin e shërbimeve sociale dhe të shërbimeve të tjera të veçanta, të cilat i nënshtrohen një regjimi të posaçëm, të thjeshtuar prokurimi;

- rritja e rolit kontrollues të APP-së në drejtim të verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë në procedurat e prokurimit, përfshi ato të anuluar dhe monitorimit të zbatimit të kontratave;

- ankimi i operatorëve ekonomikë, njëkohësisht si në autoritetin kontraktor, edhe në Komisionin e Prokurimit Publik, duke shkurtuar procesin e rishikimit administrativ të afateve të ankimit;

- parashikimi për herë të parë i konceptit të modifikimit të kontratave, si dhe rasteve të pavlefshmërisë së kontratave.

Përveç legjislacionit të prokurimit publik në fuqi ka edhe dy paketa ligjore që rregullojnë prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, koncesioneve dhe PPP-ve:

- *Ligji nr. 36/2020, “Për prokurimet e mbrojtjes dhe sigurisë”*. Ligji përcakton subjektet e prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, që përfshijnë kryesisht furnizimin me pajisje ushtarake dhe pjesët e tyre dhe/ose njësitë përbërëse të tyre, furnizimin me pajisje të klasifikuara dhe pjesët e tyre dhe/ose njësitë përbërëse të tyre, punët, furnizimet dhe shërbimet e lidhura drejtpërdrejt me pajisjet ushtarake dhe pajisjet e klasifikuara, si dhe punët, furnizimet dhe shërbimet ushtarake të cilat, për arsye sigurie, do të përfshijnë, do të kërkojnë dhe/ose do të përmbajnë informacion të klasifikuar dhe do të trajtohen si punë, furnizime dhe shërbime të klasifikuara.

- *Ligji nr. 125/2013, datë 25.4.2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar*. Dhënia e koncesioneve dhe kontratave PPP bazohet në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, efikasitetit, trajtimit të barabartë, reciprocitetit dhe sigurisë ligjore. Ky ligj rregullon kompetencat e autoriteteve kontraktore për lidhjen e marrëveshjeve koncesionare/partneriteti publik-privat për investime të bazuara në koncesion/partneritet publik-privat, procedurat për dhënien e këtyre kontratave, nënshkrimin e kontratave, zgjidhjen e kontratave dhe ndryshimet në koncesion/marrëveshjet e partneritetit publik-privat, çështjet në lidhje me rregulloret financiare dhe mbështetjen në lidhje me koncesionet/partneritetet publike-private, politikën e koncesioneve të tilla dhe autoritetin për zbatimin e tyre, si dhe çështje të tjera që lidhen me koncesionet/partneritetet publike-private.

- *Sistemi i ankesave/Rishikimi në fushën e prokurimeve publike*. Kuadri ligjor si më sipër parashikon që çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur ajo dëmtohet ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, i cili pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të paraqesë ankim njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ky ligj parashikon të drejtën e operatorëve ekonomikë për të ankimuar vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik në Gjykatën Administrative të Apelit.

Komisioni i Prokurimit Publik, në kuadër të digjitalizimit të shërbimit të shqyrtimit elektronik të

ankesave, nisi në datën 28.7.2020 punën për ngritjen e Sistemit të ri të Menaxhimit të “e-*Apelimet*” dhe “e-*Ankimet*”. Sistemi u lançua më 27.10.2021.

*Blerja e përqendruar.* Vendimi nr. 531, datë 7.9.2023, i Këshillit të Ministrave, parashikon se operatori i blerjeve të përqendruara ofron shërbimet e prokurimeve për autoritetet/entet kontraktore dhe kryen procedurat e përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.

## 1.2. KUADRI INSTITUCIONAL

Institucionet përgjegjëse në fushën e prokurimit publik janë:

**Agjencia e Prokurimit Publik (APP)** është person juridik, institucion qendror i cili, ndër të tjera, paraqet propozime ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik, nxjerr vendime, udhëzime dhe rekomandime, jep këshilla dhe asistencë etj. APP-ja koordinon dhe është institucioni lider i negociatave për anëtarësimin në BE në fushën e prokurimit publik, si dhe negociatat e anëtarësimin në GPA.

**Komisioni i Prokurimit Publik (KPP)** është person juridik publik, i pavarur dhe është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve për shqyrtimin e ankesave për procedurat e prokurimit.

**ATRAKO** – Njësia e trajtimit të koncesioneve/partneriteteve publike private asiston autoritetet kontraktore, me qëllim përgatitjen e studimit të fizibilitetit; përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit; vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë; kryerjen e negociatave dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit; monitorimin e kontratave të koncesionit.

**Ministria përgjegjëse për ekonominë** është institucioni përgjegjës, i cili orienton dhe harmonizon veprimtaritë për zhvillimin e koncesioneve/partneriteteve publike private. **Ministria përgjegjëse për financat** vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet e koncesionit/partneritetit publik-privat (PPP) nga këndvështrimi i implikimeve fiskale, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik etj.

**Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe AKSIK-ja** janë institucionet kryesore përgjegjëse për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

**Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.** është organ qendror blerës, në varësi të ministrisë përgjegjëse për ekonominë, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre.

## 1.3. VLERËSIMI I STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PROKURIMIN PUBLIK 2020–2023 DHE ZBATIMI I KUADRIT LIGJOR

Në nëntor të vitit 2020, Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023. Zbatimi i saj mbështetet te reformat që duhen ndërmarrë në 5 shtyllat kryesore, materializuar në 5 qëllime politikash (QP), që synojnë përmirësimin e mëtejshëm dhe zhvillimin e sistemit të prokurimeve: i. prokurim publik eficient dhe i qëndrueshëm; ii. përmirësimi i kuadrit ligjor për koncesionet dhe partneritetin publik-privat; iii. riorganizimi i prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë; iv. blerja e përqendruar; v. përmirësimi i sistemit të shqyrtimit dhe kontrollit të ankesave.

Gjatë kësaj periudhe është konstatuar se ka pasur zhvillime në të gjitha qëllimet e politikave të strategjisë dhe në përgjithësi ka pasur një shkallë realizimi të kënaqshme sa u takon aktiviteteve dhe treguesve të performancës. Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2020–2023 i hapi rrugën reformave dhe zhvillimeve të rëndësishme për transformimin e sistemit të prokurimeve publike në Shqipëri. Për t’u përmendur është reformimi i kuadrit ligjor në fushën e prokurimit publik dhe plotësimi i tij me akte nënligjore, si rezultat i të cilit legjislativi në këtë fushë është gjerësisht i përfunduar me *acquis* të BE-së, përmirësimi i vijueshëm i sistemit të prokurimit elektronik, lancimi i sistemit

elektronik të ankesave, plotësimi i kuadrit ligjor të prokurimeve në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, vijimi i përpjekjeve për forcimin dhe rritjen e kapaciteteve administrative etj.

Disa nga aktivitetet u përmbyllën gjatë zbatimit të SKPP 2020–2023, ndërsa të tjerat hodhën themelet për hapat e ardhshëm në fuqizimin dhe transformimin e sistemit të prokurimit publik.

Bazuar në këtë dhe sa më sipër, qasja e përgjithshme e SKPP 2024–2030 duhet të zbatohet për të çuar më tej agjendën e reformës, duke u mbështetur në bazën e krijuar tashmë. Ekziston nevoja për disa rregullime, ndryshime dhe shtesa në shtylla, megjithatë për të përshtatur strategjinë me situatën aktuale duhet të merret parasysh progresi në vitet e fundit, duke rifokusuar aktivitetet të cilat do të mundësojnë pasjen e një sistemi të prokurimit publik efikas, eficient, me performancë të mirë, mosdiskriminues, që respekton parime të tilla si mbrojtja e konkurrencës, trajtimit të barabartë etj.

Kuadri ligjor institucional në fushën e prokurimit publik në 3 vitet e fundit ka pësuar një ndryshim rrënjësor dhe përmirësim të ndjeshëm, me objektivin kryesor hyrjen e vendit në BE. Kuadri ynë ligjor ka përafëruar direktivat përkatës të BE-së, duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në përmirësimin e sistemit të prokurimit në Shqipëri në përputhje edhe me rekomandimet e BE-së apo organizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Konstatohet se ka pasur rritje të transparencës në procesin e prokurimit nëpërmjet uljes së konsiderueshme të numrit të procedurave me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Konkretisht, lidhur me procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, numri total i procedurave të prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, të zhvilluara gjatë vitit 2022, është 3,3% i numrit total (procedura të tjera + negociim pa shpallje) të procedurave të përfunduara me fitues. Shprehur në vlerë, vlera e prokuruar me procedurën me negociim pa shpallje është vetëm 0.9% në raport me vlerën e prokuruar (procedura të tjera + negociim pa shpallje).

Kriteri i vlerësimit ~ oferta ekonomikisht më e favorshme ~ bazuar në kosto, ka filluar të përdoret nga autoritetet kontraktore, duke synuar rritjen e cilësisë së kontratës të lidhur në fund të procesit të prokurimit. Ligji parashikon qartazi përdorimin nga ana e autoriteteve kontraktore të kriterëve që lidhen me cilësinë e produktit, kriteret mjedisore, sociale apo ciklin jetësor të tij duke garantuar eficiencë më të lartë dhe kosto më të ulët për autoritetin/entin kontraktor. Në vitin 2022, rreth 7,3% e procedurave janë përzgjedhur duke përdorur si kriter vlerësimi ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto të cilat përbëjnë 33,92% të fondit limit përkatës ndaj totalit. Ky tregues ka ardhur në rritje krahasuar me periudhat e mëparshme.

Gjatë vitit 2022, Komisioni i Prokurimit Publik ka rritur shpejtësinë e shqyrtimit të ankesave, si në drejtim të numrit total të ankesave të trajtuara jashtë afatit, gjithashtu, edhe në numrin e ditëve të trajtimit të një anese pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Kështu që, nëse për vitin 2021 përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit ishte në vlerën 10.8%, në vitin 2022 është ulur në vlerën 10.1% përqindja e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit.

## 2. VIZIONI I STRATEGJISË 2024–2030

Vizioni i strategjisë: strategjia synon të garantojë një sistem prokurimi eficient dhe të qëndrueshëm, duke promovuar përmirësimin e tij drejt një qasjeje moderne dhe eficiente të bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Qëllimi i një prokurimi efektiv është që të sigurojë mallra dhe shërbime me çmime më të mira për cilësi më të mirë. Kjo synohet të arrihet duke harmonizuar procesin e prokurimit publik për të siguruar një përdorim të arsyeshëm, ekonomik dhe efikas të fondeve publike për të garantuar që prokurimi publik të kryhet në mënyrë të drejtë, transparente dhe jodiskriminuese, duke promovuar një proces konkurrues.

Parimet e përgjithshme: strategjia mbështetet në parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar e nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para, bazuar edhe te rritja e kapaciteteve administrative,

implementimi i ligjit, ligjshmëria gjatë procedurës së rishikimit etj.

## 2.1. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Strategjia për Prokurimin Publik 2024–2030 parashikon një sërë objektivash strategjike për secilin qëllim të politikave, lidhur me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit publik, koncesioneve dhe PPP, prokurimeve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë, ngritjen dhe funksionimin e Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, forcimin e kapaciteteve administrative etj. Një rëndësi e veçantë i kushtohet promovimit të konkurrencës me masa të dedikuara në bashkëpunim edhe me institucione të tjera. Gjithashtu, integriteti dhe masat antikorrupsion pasqyrohen në një seksion të posaçëm.

Objektivat e strategjisë mbështeten në parime, të cilat synojnë:

- eficiencën dhe efektivitetin e prokurimit publik;
- zhvillimin ekonomik të vendit, nëpërmjet një sistemi eficient të prokurimit publik dhe rritjes së kapaciteteve administrative;
- promovimit të konkurrencës dhe nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, sidomos SME-ve në procedurat e prokurimit publik;
- sigurimit të mundësive të barabarta nëpërmjet trajtimit të barabartë për të gjithë ofruesit;
- promovimit të integritetit, llogaridhënies në procesin e prokurimit publik;
- sigurimit të transparencës së procedurave dhe vendimmarrjes;
- zhvillimet teknologjike në fushën e prokurimeve publike;
- garantimin e procedurave të qëndrueshme të prokurimit publik në respektim të mirëqenies sociale dhe mbrojtjes së mjedisit etj.

## 2.2. INDIKATORËT KRYESORË

Zbatimi i masave dhe i aktiviteteve të Strategjisë duhet të ketë ndikim në rritjen e efikasitetit të sistemit kombëtar të prokurimit publik, por edhe në zhvillimin e përgjithshëm të tregut, si dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike.

Qëllimi i treguesve kryesorë të impaktit është të monitorojnë progresin dhe tendencat drejt qëllimeve të përcaktuara strategjike. TKP (treguesit kyç të performancës) përfaqësojnë objektivat kryesorë që duhet të gjurmohen për të pasur ndikimin më të madh në rezultatet e përcaktuara strategjike.

Prandaj, TKP-të e mëposhtme do të përdoren për të monitoruar arritjen e qëllimeve strategjike në prokurimin publik:

### *INDIKATORI 1: PROMOVIMI I KONKURRENCËS*

Masat e planifikuara në këtë strategji synojnë të ofrojnë transparencë në çdo fazë të procesit të prokurimit, të garantojnë konkurrencën e drejtë në procedurat e prokurimit, duke promovuar trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe duke rritur integritetin e AK-së dhe OE-së për të shmangur shtrembërimin e konkurrencës.

Në këtë kuptim, ky indikator do të matet:

- nëpërmjet numrit mesatar të ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit;
- nëpërmjet numrit të procedurave negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj numrit total të procedurave të prokurimit të përfunduara me fitues (procedura të tjera + negociim pa shpallje).

### *INDIKATORI 2: PROMOVIMI I PJESËMARRJES SË SME-VE NË PROCEDURAT E PROKURIMIT*

Kuadri ligjor në fushën e prokurimeve ka frymën e lehtësimit dhe të nxitjes së pjesëmarrjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Meqenëse prokurimi publik duhet të përshtatet me nevojat e SME-ve, një prej qëllimeve të shumë aktiviteteve brenda kësaj Strategjie është lehtësimi i pjesëmarrjes së SME-ve në prokurimin publik.

Ky tregues matet me përqindjen e kontratave të prokurimit publik të dhëna për SME-të në raport me numrin total të kontratave.

### INDIKATORI 3: CILËSI MË E MIRË PËR MALLRA, PUNË DHE SHËRBIME

Masat e planifikuara legislative dhe zbatuese duhet të rezultojnë në rritjen e përdorimit të kriterëve më të mira për përcaktimin e ofertës fituese, bazuar mbi raportin çmim/cilësi në ofertën ekonomikisht më të favorshme në krahasim me kriterin e çmimit më të ulët. Kjo duhet të rezultojë në përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të mallrave, punëve dhe shërbimeve të blera, duke pasur një ndikim indirekt në rritjen e cilësisë së shërbimit publik të ofruar nga autoritetet kontraktore. Për të arritur këtë qëllim, synohet drejt rritjes së përdorimit të kriterit të ofertës ekonomike më të favorshme bazuar në kosto.

Ndikimi i Strategjisë do të vlerësohet në bazë të vlerës së kontratave të dhëna, bazuar në raportin më të mirë çmim/cilësi.

### INDIKATORI 4: RRIJTJA E NUMRIT TË PROCEDURAVE TË REALIZUARA ME FITUES

Një nga ndikimet kryesore të prokurimit të përqendruar është standardizimi i proceseve të prokurimit, si dhe standardizimi i karakteristikave të artikujve të blerë. Si pasojë, përdorimi i mallrave dhe i shërbimeve të standardizuara duhet të rezultojë në shërbime më të standardizuara të ofruara nga ato organe.

Ndikimi i duhur i zbatimit të strategjisë do të matet bazuar në numrin e procedurave të prokurimit të realizuara me fitues nga operatori i blerjeve së përqendruara.

### INDIKATORI 5: RRIJTJA E PËRDORIMIT TË KRITEREVE MJEDISORE DHE SOCIALE

Autoritetet kontraktore, duke përdorur kompetencat e tyre në prokurim për të zgjedhur mallra, punë dhe shërbime me standarde më të larta mjedisore dhe sociale mund të japin një kontribut të rëndësishëm në konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm. Prokurime të tilla kanë impakt të drejtpërdrejtë mjedisor dhe social të shërbimeve të ofruara nga organet publike.

Ndikimi i Strategjisë do të vlerësohet duke matur numrin e procedurave të prokurimit ku janë përdorur kriteret/elemente mjedisore ose sociale (specifikimet teknike, kriteret e dhënies së kontratës, kushtet e kontratës).

### INDIKATORI 6: RRIJTJA E EFICIENCËS SË SISTEMIT TË ANKESAVE NËPËRMJET RRIJTJES SË SHPEJTËSISË NË VENDIMMARRJE

Një sistem shqyrtimi i ankesave, i cili është mirëfunksional, siguron një zbatim më të mirë të legjislacionit të prokurimit publik, duke garantuar që shkeljet e kryera nga autoritetet kontraktore të korrigjohen. Një nga ndikimet kryesore të sistemit të shqyrtimit të ankesave në eficiencën e të gjithë procesit të prokurimit është shpejtësia në marrjen e vendimeve nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).

Ndikimi do të vlerësohet duke matur numrin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit të parashikuar në ligj mbi numrin e ankesave totale të depozituara pranë KPP-së në një vit.

Treguesit e rezultatit janë përcaktuar për secilin aktivitet dhe janë përfshirë në aneksin 2.

Tabela 1: Treguesit e ndikimit dhe rezultatit në SKPP 2024–2030

TKP	Metoda e llogaritjes	Vlera bazë (2023)	Vlera e synuar (2030)
PROMOVIMI I KONKURRENCËS	Ndikimi do të matet: 1. Npërmjet numrit mesatar të ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit krahasuar me vitin e mëparshëm; si dhe 2. Npërmjet procedurave negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj numrit total të procedurave të prokurimit të përfunduara me fitues (procedura të tjera + negociim pa shpallje)	3.37  2.9 %	Numri mesatar i ofertave jo më pak se 2.5  Negocimet pa shpallje jo më shumë se 10%
PROMOVIMI I PJESËMARRJES SË SME-ve	Ndikimi do të vlerësohet duke matur përqindjen e kontratave të prokurimit publik të dhëna për SME-të në raport me vitin e kaluar	93.9%	Jo më pak se 50%
CILËSI MË E MIRË PËR MALLRA, PUNË DHE SHËRBIME	Ndikimi do të vlerësohet duke matur vlerën e kontratave të dhëna bazuar në raportin më të mirë çmim/cilësi brenda kriterëve të ofertës	20.33 %	Trend rritës

	ekonomikisht më të favorshme (MEAT) në raport me vitin e kaluar		
RRITJA E NUMRIT TË PROCEDURAVE TË REALIZUARA ME FITUES	Ndikimi do të matet bazuar në numrin e procedurave të prokurimit të realizuara me fitues nga Operatori i Blerjeve së Përqendruara.	2.5%	Trend rritës
RRITJA E PËRDORIMIT TË KRITEREVE MJEDISORE DHE SOCIALE	Ndikimi do të vlerësohet duke matur procedurat e prokurimit me elemente mjedisore ose sociale të përdorura (specifikimet teknike, kriteret e dhënies së kontratës, kushtet e kontratës) krahasuar me një vit më parë	N/A	Trend rritës
RRITJA E EFICIENCËS SË SISTEMIT TË ANKESAVE NËPËRMJET RRRITJES SË SHPEJTËSISË NË VENDIMMARRJE	Ndikimi do të vlerësohet duke matur numrin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit të parashikuar në ligj mbi numrin e ankesave totale të depozituara pranë KPP-së në një vit.	9.4 %	Trend zbritës

## PJESA E DYTË

### QËLLIMET E POLITIKAVE, OBJEKTIVAT STRATEGJIKË, MASAT IMPLEMENTUESE

Dokumenti është i strukturuar në tri shtylla kryesore që pasqyrojnë politikat kryesore të strategjisë, përkatësisht qëllimet afatgjata të politikave. Çdo shtyllë përshkruan një sërë komponentësh me objektiva specifike dhe masa konkrete për secilën. Fushat e ndërhyrjes nën çdo shtyllë përfshijnë të gjitha aspektet e sistemit të prokurimit publik, përfshirë kontratat e prokurimit publik, duke përfshirë edhe kontratat në sektorët e mbrojtjes e të sigurisë, koncesionet, PPP-të dhe procedurat e rishikimit.

Për secilin komponent jepet një përshkrim i shkurtër i situatës aktuale dhe domosdoshmëria për të ndërhyrë, nëpërmjet masave konkrete, me qëllim përmirësimin apo rregullimin duke synuar arritjen e këtij objekti.

Për secilën masë janë listuar prioritetet dhe institucionet përgjegjëse. Të gjitha masat, në rang shtyllash dhe përbërësish, si dhe afatet kohore janë paraqitur në planin e veprimit në aneksin 1.

Për përgatitjen dhe implementimin e duhur të Strategjisë nevojitet përfshirja e disa institucioneve, si: Agjencia e Prokurimit Publik, ministria përgjegjëse për financat, ministria përgjegjëse për ekonomisë, ATRAKO, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale, ministria përgjegjëse për infrastrukturën, ministria përgjegjëse për energjinë, ministria përgjegjëse për turizmin, ministria përgjegjëse për mjedisin, Operatori i Blerjeve të Përqendruara, Komisioni i Prokurimit Publik, ministria përgjegjëse për antikorrupsionin, ASPA, DAP-i, Autoriteti i Konkurrencës, AKSHI, ILDKPKI-ja, AKSIK-ja, si dhe institucione të tjera, të cilat do të jenë përgjegjëse për implementimin e masave të lidhura me fushën e tyre të veprimit. Për këtë arsye, do të ngrihet një komitet drejtues me detyrë koordinimin dhe menaxhimin e Strategjisë.

**QËLLIMI I POLITIKËS 1 – PROCESI I PROKURIMIT PUBLIK EFICIENT DHE EFEKTIV**

**QËLLIMI I POLITIKËS 2 – PROKURIMI I QËNDRUESHËM DHE INOVATIV**

**QËLLIMI I POLITIKËS 3 – INTEGRITETI DHE LIGJSHMËRIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

**1. QËLLIMI I POLITIKËS 1 – PROCESI I PROKURIMIT PUBLIK EFICIENT DHE EFEKTIV**

Procesi i prokurimit publik për blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve duhet të jetë eficient dhe efektiv. Përpjekjet e të gjitha palëve në këtë proces do të kontribuojnë në një menaxhim efikas dhe efektiv të burimeve publike. Objektivi parësor i prokurimit i referohet blerjes së mallrave, shërbimeve dhe punëve të nevojshme për të përmbushur misionin e autoriteteve kontraktore në kohë, në mënyrë ekonomike dhe efikase.

Për këtë kërkohet një kuadër ligjor i qartë, i thjeshtë dhe koherent, që shmang kërkesat e panevojshme; një kuadër institucional i qëndrueshëm dhe që trajton ofertuesit në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe transparente. Këto janë elemente të rëndësishme që sigurojnë dhe mundësojnë rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në prokurimin publik.

Sistemi i rishikimit të drejtë, në kohë dhe transparent, bazuar në integritetin dhe drejtësinë e sistemit të prokurimit publik krijon besimin e duhur tek operatorët ekonomikë, duke përfshirë dhe konkurrentët e huaj.

Me qëllim garantimin e një sistemi prokurimi eficient dhe efektiv është e nevojshme marrja e një sërë masash, sidomos sa u takon aspekteve të mëposhtme:

1. PËRMIRËSIMI I MËTEJSHËM I KUADRIT LIGJOR;
  2. FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE;
  3. PËRMIRËSIMI I BLERJES SË PËRQENDRUAR;
  4. FUQIZIMI I KAPACITETEVE ZBATUESE.
- 1.1 OBJEKTIVI SPECIFIK 1 – PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR;

#### **Konteksti**

Ligji nr. 162/2020 është një ligj i përafuar gjerësisht me direktivat e BE-së, por nevoja për një përafrim të disa dispozitave dhe pasqyrimi i problematikave të hasura në zbatimin gjatë këtyre viteve të fundit solli domosdoshmërinë e rishikimit të ligjit.

Qëllimi kryesor është të përmirësojë kuadrin rregullator të prokurimit publik në Shqipëri, duke synuar përafrimin e mëtejshëm të ligjit me direktivat e BE-së, kjo edhe si pjesë dhe e angazhimeve të marra në vijim të takimit dypalësh, në kuadër të procesit “*screening*” për kapitullin 5 “Prokurimi publik”, të zhvilluar në datën 18 nëntor 2022, në Bruksel, por edhe duke analizuar problematikat e dala gjatë zbatimit të këtij ligji në praktikë prej muajit mars 2021 nga autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë, me qëllim lehtësimin e procesit të prokurimit për të gjitha palët e përfshira në të.

Objektivat konkretë që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji është përmirësimi i kuadrit rregullator në fushën e prokurimit publik nëpërmjet transpozimit të mëtejshëm të direktivave të BE-së, adresimi i paqartësive dhe problematikave të dala nga zbatimi në praktikë i ligjit prej një periudhe 2-vjeçare nga hyrja e tij në fuqi, si dhe duke sqaruar terminologjinë e përdorur në disa dispozita ligjore. Gjithashtu, do të synohet drejt rritjes së mëtejshme të transparencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit, kryerjes së procedurave të prokurimit, depozitimit të ankesave dhe menaxhimit të zbatimit të kontratave, duke përdorur vetëm mjete elektronike të komunikimit, nëpërmjet sistemeve përkatëse elektronike dhe ndërveprimit të tyre me sisteme të tjera.

#### **Objektivi**

Objektivi kryesor është procesi i përafrimit të legjislacionit në kuadër të procesit të integritetit evropian, duke pasur në vëmendje ndër të tjera parashikime ligjore lidhur me konceptin e veprimtarisë ndihmëse dhe ofruesit e shërbimit të prokurimit, parashikimin e zhvillimit të procedurave të prokurimit, të kryerjes së ankesave dhe menaxhimit të zbatimit të kontratave duke përdorur mjete elektronike të komunikimit, rishikimin e disa dispozitave të ligjit duke reflektuar problematika të hasura, riformulimin e nenit lidhur me blerjen e përqendruar si dhe parashikime të tjera ligjore.

Objektivi i mësipërm parashikohet të arrihet nëpërmjet masave të mëposhtme:

#### **MASA 1.1.1. RISHIKIMI I LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Nëpërmjet ndryshimeve në LPP, në vitin 2024 synohet të përmirësohet kuadri rregullator i prokurimit publik në Shqipëri, duke e përafuar më tej kuadrin ligjor me *acquis* të BE-së dhe parashikimin e dispozitave për zhvillime të mëtejshme të teknologjisë.

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja, KPP-ja, AKSHI.

Treguesit e performancës:

- analiza e legjislacionit;

- tabela e përputhshmërisë;
- hartimi i amendimeve të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”;
- miratimi i amendimeve të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” në Kuvend;

#### MASA 1.1.2. RISHIKIMI I AKTEVE NËNLIGJORE NË PËRPUTHJE ME LIGJIN E PROKURIMEVE PUBLIKE

Rishikimi i ligjit do të pasojë edhe me rishikimin e kuadrit ligjor dytësor në fushën e prokurimeve, që do të jetë në formën e amendimeve ligjore ose do të hartohen dhe do të miratohen akte të reja nënligjore.

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja.

Treguesit e performancës:

- hartimi dhe miratimi i draftamendimeve të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;

- hartimi dhe miratimi i një VKM-je të veçantë lidhur me kufijtë monetarë, e cila do të përafrohet me kufijtë monetarë të parashikuar në direktivën 2014/24/BE dhe 2014/25/BE, duke trajtuar kështu një nga boshllëqet ligjore të identifikuara.

- materiale të tjera ndihmëse.

#### MASA 1.1.3 – PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR TË KONCESIONEVE DHE PPP

Qeveria e Shqipërisë ka parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian 2023–2025, në lidhje me fushën e koncesioneve dhe PPP-ve, rishikimin e ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

Është ngritur një grup ndërinstitucional pune për rishikimin e ligjit për koncesionet dhe PPP-të, në mënyrë që të përafrohet me direktivën 2014/23/BE. Për hartimin e ligjit të koncesioneve dhe PPP-të, GNP-ja po ndihmohet nga eksperti i SIGMA-s, i cili kishte kryer edhe analizën e mangësive ligjore për këtë ligj.

Kuadri ligjor në fushën e koncesioneve duhet të mbështetet në parimet dhe rregullat e BE-së që respektojnë mosdiskriminimin, trajtimin e barabartë dhe transparencën, kriteret e vlerësimit, procedurat dhe rregullat në lidhje me prokurimin elektronik, sikurse janë komunikimi elektronik, njoftimet e kontratave dhe njoftimet e fituesit. Sidoqoftë, siç është treguar nga raportet vjetore të KE-së, rekomandimet e vijueshme lidhen me domosdoshmërinë e përmirësimit të legjislacionit në këtë fushë i cili ka nevojë për përmirësime të mëtejshme, në mënyrë që të arrihet përafrimi me direktivën përkatëse. Nga ana tjetër, për një zbatim më të mirë të legjislacionit është e nevojshme edhe një ndërhyrje në kuadrin institucional të tij.

Gjithashtu, rëndësi në këtë proces ka roli dhe përgjegjësia e ministrisë përgjegjëse për financat dhe ministrisë përgjegjëse për ekonominë, në lidhje me vlerësimin, miratimin e të gjitha projekteve të koncesionit/partneritetit publik privat dhe ecurinë e kontratave të koncesionit/PPP nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale.

Institucionet përgjegjëse:

ATRAKO-ja, APP-ja, ministria përgjegjëse për financat, ministria përgjegjëse për ekonominë.

Treguesit e performancës:

- analiza e legjislacionit;
- tabela e përputhshmërisë;
- hartimi i kuadrit të ri ligjor në fushën e koncesioneve dhe PPP-të;
- miratimi i i kuadrit të ri ligjor në fushën e koncesioneve dhe PPP-të në Kuvend;
- përmirësimi i rolit politikëbërës i ATRAKO-s;
- materiale të tjera ndihmëse.

#### MASA 1.1.4. MIRATIMI I AKTEVE NËNLIGJORE NË FUSHËN E KONCESIONEVE

## DHE PARTNERITET PUBLIK PRIVAT

Ligji i ri në fushën e koncesioneve dhe PPP-të do të pasojë edhe me rishikimin e kuadrit ligjor dytësor.

Institucionet përgjegjëse:

ATRAKO-ja, ministria përgjegjëse për financat; ministria përgjegjëse për ekonominë, APP-ja.

Treguesit e performancës:

- hartimi i kuadrit ligjor sekondar në fushën e koncesioneve dhe PPP-të në përputhje me ligjin e ri të koncesioneve;

- hartimi i VKM-ve, udhëzimeve etj.;

- materiale të tjera ndihmëse.

### MASA 1.1.5. PËRMIRËSIMI I KUADRIT NËNLIGJOR NË FUSHËN E MBROJTJES DHE SIGURISË

Kuadri ligjor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë nevojitet të përmirësohet duke reflektuar legjislacionin e BE-së, problematikat e hasura, si dhe rekomandimet e KE-së. Kjo masë parashikon amendime në ligjin nr. 36/2020, “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, me qëllim përafrimin e mëtejshëm me kuadrin ligjor të direktivës 2009/81/EC, si dhe amendime në kuadrin nënligjor për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Objektivi kryesor është përmirësimi i procedurave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë nëpërmjet hartimit dhe miratimit të amendimeve ligjore dhe nënligjore.

Institucionet përgjegjëse:

MM-ja, MB-ja, APP-ja, AKSIK-ja.

Treguesit e performancës:

- hartimi dhe miratimi i amendimeve në legjislacionin dytësor përkatës në zbatim të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;

- materiale të tjera ndihmëse.

### MASA 1.1.6. PROCESI I ADERIMIT NË GPA-OBT

Republika e Shqipërisë është riaktivizuar në procesin e anëtarësimit në Marrëveshjen e OBT-së për Prokurimin Qeveritar. Në vitin 2001, Shqipëria ka depozituar kërkesën për t’u anëtarësuar dhe pas një periudhe joaktive, në vitin 2022 ka rinisur procesin me ngritjen e një grupi ndërinstitucional pune, bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 156, datë 28.9.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e kushteve të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Prokurimit Publik të Organizatës Botërore të Tregtisë”. Në datën 27 korrik 2023, Shqipëria depozitoi zyrtarisht, nëpërmjet Misionit Permanent të Shqipërisë në Gjenevë, pyetësorin (*checklist*), me pyetje specifike ku pasqyrohej informacioni lidhur me kuadrin ligjor në fushën e prokurimit publik, implementimin e tij, disa të dhëna të tjera plotësuese etj., i cili u shpërnda nga Sekretariati Teknik i GPA-OBT te shtetet anëtare të GPA për komente dhe sqarime shtesë.

Në datën 3 gusht 2023, pyetësori së bashku me kuadrin ligjor u shpërnda nga Sekretariati Teknik i GPA-OBT te shtetet anëtare të GPA-së për komente dhe sqarime shtesë.

Objektivi kryesor është plotësimi i detyrimeve dhe aderimi i Shqipërisë në Marrëveshjen e Prokurimeve Qeveritare GPA të Organizatës Botërore të Tregtisë.

Objektivi i mësipërm është parashikuar të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja, ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për financat; ministria përgjegjëse për ekonominë.

Treguesit e performancës:

- finalizimi dhe dorëzimi i ofertës së parë ekonomike në Sekretariatun e GPA-së;

- realizimi i takimeve bilaterale dhe negociatave;

- aderimi i Shqipërisë në GPA-OBT.

## 1.2 OBJEKTIVI SPECIFIK 2 – FORCIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

### **Konteksti**

Aktivitetet e këtij objekti specifik lidhen me forcimin e kapaciteteve në përputhje me kompetencat ligjore nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm, sipas planeve të trajnimit të hartuara, rritjen e numrit të stafeve të trajnuara, realizimi i vizitave studimore/trajnimeve në vendet e tjera etj.

Stafet respektive duhet të trajnohen me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të tyre, të cilat janë përgjegjës për mirëmbajtimin e kuadri ligjor në fushën e prokurimit, koncesioneve, PPP-ve, prokurimeve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë etj.

### **Objektivi**

Objektivi është rritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale, fuqizimi i rolit të institucioneve si APP-ja, ATRAKO-ja, MM-ja, MB-ja, OBP-ja, KPP-ja etj., në respektim të dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve dhe duke synuar forcimin e vijueshëm të kapaciteteve institucionale.

Objektivi i mësipërm parashikohet të arrihet nëpërmjet masave të mëposhtme:

#### MASA 1.2.1. TRAJNIMI I STAFIT

Kapacitetet administrative të institucioneve përgjegjëse janë duke u përforcuar vazhdimisht, nëpërmjet edhe pjesëmarrjes në seminare dhe trajnime të organizuara nga autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja, ATRAKO-ja, MB-ja, MM-ja, KPP-ja, OBP-ja, ministria përgjegjëse për financat; ministria përgjegjëse për ekonominë etj.

Treguesit e performancës:

- plani i trajnimit të stafeve;
- fuqizimi i kapaciteteve institucionale, paralelisht me procesin e përafrimit të legjislacionit të ri kombëtar;
- trajnime të vazhdueshme të punonjësve sipas fushave, njohja e stafeve me amendimet ligjore;
- rritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e kuadrit rregullator;
- shkëmbimi i njohurive dhe praktikave më të mira me autoritete partnere nga vendet e BE-së etj.;
- pjesëmarrje në trajnime të zhvilluara, *workshop*-e, seminare, vizita studimore;
- Stafit i APP-së, ATRAKO-s, MB-së, MM-së, KPP-së, OBP-së, ministrisë përgjegjëse për financat; ministrisë përgjegjëse për ekonominë etj. i trajnuar.

#### MASA 1.2.2. FORCIMI I KAPACITETEVE TË ATRAKO-S

Miratimi i ligjit të ri në fushën e koncesioneve dhe PPP-të do të shoqërohet me rritjen e kapaciteteve të ATRAKO-s, duke rritur dhe forcuar kapacitetet administrative në këtë institucion.

Institucionet përgjegjëse:

ATRAKO-ja, ministria përgjegjëse për financat; ministria përgjegjëse për ekonominë

Treguesit e performancës:

- struktura dhe organigrama e re e miratuar;
- rekrutimi i stafit;
- rritja e kapaciteteve të autoriteteve kontraktore për të kuptuar më mirë se si dhe kur duhen përdorur koncesionet apo PPP-të;
- trajnime të zhvilluara.

## 1.3. OBJEKTIVI SPECIFIK 3 – PËRMIRËSIMI I BLERJES SË PËRQENDRUAR

### **Konteksti**

Bazuar në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjes të Përqendruara” sh.a., për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë”, parashikohet krijimi i shoqërisë aksionare për ofrimin e shërbimeve të prokurimeve për autoritetet/entet kontraktore. OBP sh.a. është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në

kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.

#### **Objektivi**

Objektivi është riorganizimi i blerjeve të përqendruara, me qëllim realizimin me efektivitet dhe efektshmëri të procedurave të prokurimit, parashikime konkrete në ligj për aplikimin e tarifave etj.

Objektivi i mësipërm pritet të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

#### **MASA 1.3.1. NGRITJA E OPERATORIT TË BLERJES SË PËRQENDRUAR SHA**

Bazuar në vendimin nr. 531, datë 7.9.2023, të Këshillit të Ministrave, është riorganizuar blerja e përqendruar dhe është ngritur Operatori i Blerjes së Përqendruar, si organ qendror blerës, cili zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve për kategori të caktuara të objekteve të prokurimit dhe kategori të caktuara të autoriteteve kontraktore.

OBP sh.a. financohet nga të ardhurat e veta, të ardhura nga shërbimet ndaj të tretëve, të konsulencës, nga ofrimi i shërbimeve dhe burime të tjera të ligjshme. Operatori i Blerjes së Përqendruar, si organi qendror blerës për kryerjen e procedurave të prokurimit në emër dhe për llogari të autoriteteve ose enteve kontraktore do të organizohet si institucion publik apo si shoqëri aksionare në pronësi të shtetit dhe kryen procedurat e prokurimit sipas sektorëve përkatës, të përcaktuara në vendimin e krijimit të tij. Organi qendror blerës kryen veprimtari në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik dhe çdo legjislacion tjetër të zbatueshëm në fuqi.

Tarifa për kryerjen e veprimtarive ndihmëse për prokurimin publik nga organi qendror blerës, i krijuar sipas kësaj pike, dhe përlllogaritja e saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Institucionet përgjegjëse:

OBP sh.a., ministria përgjegjëse për ekonominë, APP-ja.

Treguesit e performancës:

- struktura dhe organika e re e OBP sh.a., e miratuar;
- vlerësimi i veprimtarisë së OBP sh.a. dhe zhvillimi i procedurave në kuadër të blerjes së përqendruar;
- akte nënligjore të hartuara dhe të miratuara në mbështetje të praktikave më të mira ndërkombëtare;
- rekrutimi i stafit;
- funksionimi dhe operimi i OBP sh.a.

#### **MASA 1.3.2. PËRMIRËSIMI I EFICIENCËS SË PROKURIMEVE TË PËRQENDRUARA**

Dispozitat e ligjit nr. 1, 62/2020, parashikojnë se kur një ose më shumë autoritete ose ente kontraktore kanë nevojë për të njëjtat mallra, punime apo shërbime, atëherë ata mund t'i ngarkojnë njërit prej tyre detyrën e prokurimit të këtyre mallrave, punimeve apo shërbimeve në emër të të tjerëve. Me vendim të Këshillit të Ministrave janë caktuar institucione, si AKSHI, OBP-ja apo ministria përgjegjëse për shëndetësinë si organ qendror blerës.

Në cilësinë e organit qendror blerës, këto institucione duhet të realizojnë me efektivitet dhe eficiencë kryerjen e një procedurë të caktuar prokurimi, kur blerja e përqendruar do të ishte më e leverdishme, për shkak të rritjes së sasisë së kërkuar për furnizimet me mallra të ngjashme dhe kushte të ngjashme sipas tregut.

Institucionet përgjegjëse:

OBP-ja, ministria përgjegjëse për shëndetësinë, AKSHI, APP-ja, ASPA.

Treguesit e performancës:

- numri i procedurave të prokurimit të realizuara me fitues;
- trajnime të vazhdueshme të punonjësve sipas fushave, njohja e stafeve me amendimet ligjore;
- pjesëmarrje në *workshop*, seminare për sa i përket fushës së prokurimit publik.

#### **1.4. OBJEKTIVI SPECIFIK 4 – FUQIZIMI I KAPACITETEVE ZBATUESE**

## **Konteksti**

Politikat e profesionalizimit në nivel kombëtar janë thelbësore për të siguruar që personat e përfshirë në procesin e prokurimit publik, pjesë e autoriteteve kontraktore, të kenë aftësitë, njohuritë dhe integritetin e nevojshëm. Profesionalizimi lidhet me trajnimin dhe menaxhimin e karrierës së praktikuesve të prokurimit publik, duke ofruar mjete për ta bërë procesin e prokurimit më efikas.

Profesionalizimi dhe ngritja e kapaciteteve të AK-ve është përfshirë në Strategjinë për Prokurimin Publik 2020–2023 dhe APP-ja ka bashkëpunuar me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). Nga ky bashkëpunim, është finalizuar Udhërrëfyesi i Profesionalizimit dhe kurrikulat e trajnimit.

Konkretisht, ekzistojnë katër kurrikula trajnimi për nivelet bazë, të mesme, të avancuara dhe të ekspertëve, bazuar në modelin ProcurCompEU. Në mars të vitit 2023 u finalizua programi i trajnimit të trajnerëve, ku u trajnuan 19 kandidatë të suksesshëm dhe u certifikuan me “Certifikatën e trajnerit të prokurimit publik”. Pas përfundimit të trajnimit të trajnerëve dhe certifikimit të tyre, si dhe kurrikulave të finalizuara, në muajt qershor–korrik dhe në shtator 2023 u finalizua pilotimi i sesioneve trajnuese për nivelin bazë për punonjësit e AK-së.

## **Objektivi**

Hartimi dhe zbatimi i një plani trajnimi për nëpunësit e administratës shtetërore të përfshirë në proces, duke synuar ngritjen dhe funksionimin e një rrjeti të profesionistëve të prokurimit. Rishikimi i kriterëve specifike që duhen plotësuar për punonjës prokurimi dhe rishikimi i përshkrimeve të vendit të punës për këto pozicione.

Objektivi i mësipërm është parashikuar të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

### **MASA 1.4.1. PROFESIONALIZIMI I FUNKSIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Profesionalizimi i funksionit të prokurimit do të mundësonte që çdo i punësuar në sektorin publik, që merret me prokurimin publik, të jetë i trajnuar dhe i certifikuar në përputhje me parimet, rregullat dhe procedurat e prokurimit publik duke kontribuar kështu në përmirësimin e performancës së sistemit të prokurimit në tërësi. Për këtë arsye, duhet të përgatitet një plan shumëvjeçar profesionalizimi, ku të përcaktohen të gjithë hapat e nevojshëm për profesionalizimin.

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja, ASPA, DAP-i.

Treguesit e performancës:

- nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me ASPA-n;
- nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me DAP-in;
- hartimi dhe zbatimi nga ASPA në bashkëpunim me APP-në i një plani trajnimi për nëpunësit e administratës shtetërore të përfshirë në këtë proces;
- zhvillimi i trajnimeve, duke synuar një numër të caktuar personash të trajnuar në çdo autoritetet kontraktor;
- rishikimi i kriterëve specifike dhe të përshkrimit të vendit të punës për punonjësit e prokurimit publik në institucionet, pjesë e fushës së veprimit të legjislacionit për nëpunësin civil, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik;
- hartimi dhe miratimi i amendimeve të akteve nënligjore në kuadër të rishikimit të kriterëve specifike dhe të përshkrimit të punës për punonjësit e prokurimit publik që janë nëpunës civilë.

### **MASA 1.4.2. RRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT**

APP-ja u vjen në ndihmë autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë duke hartuar dhe miratuar herë pas herë materiale ndihmëse në formën e udhëzimeve, rekomandimeve, opinioneve, manualeve teknike etj.

Institucione përgjegjëse:

APP-ja, KPP-ja.

Treguesit e performancës:

- publikimi në faqen e APP-së i udhëzimeve, rekomandimeve, njoftimeve dhe udhërrëfyesve;
- hartimi dhe publikimi i komentarit të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”.

## 2. QËLLIMI I POLITIKËS 2 – PROKURIMI I QËNDRUESHËM DHE INOVATIV

Legjislacioni kombëtar parashikon dhe inkurajon përdorimin e prokurimeve të gjelbra, sociale dhe inovative. Autoritetet kontraktore mund të marrin parasysh shumë aspekte kur blejnë punë, mallra ose shërbime. Shembujt përfshijnë mbrojtjen e mjedisit, mbështetjen e aspekteve sociale dhe nxitjen e inovacionit, eficiencën e energjisë etj. Megjithatë, akoma gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit autoritetet kontraktore vijnë përdorimin e çmimit më të ulët si kriterin kryesor për dhënien e kontratave publike. Kjo tregon se blerësit publikë ndoshta nuk po u kushtojnë vëmendje të mjaftueshme cilësisë, qëndrueshmërisë dhe inovacionit. Për të mbështetur përfshirjen e mëtejshme të prokurimit strategjik, ashtu si edhe në BE edhe në Shqipëri, janë hartuar dhe miratuar udhëzime dhe udhërrëfyes të rinj për përdorimin e kriterëve novatore, të gjelbra dhe sociale.

Prokurimi i qëndrueshëm do të vazhdojë të jetë si objektivi kyç në Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030. Në përputhje me Strategjinë, do të bëhen përpjekje për ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktore për përdorimin e kriterëve të prokurimit publik të gjelbër.

Objektivat e politikës i referohen prokurimit të qëndrueshëm me bazë përdorimin e kriterëve *green*, prokurimin social, inovacionin etj.

Me qëllim garantimin e një sistemi prokurimi eficient dhe efektiv është e nevojshme marrja e një sërë masash, sidomos sa u takon aspekteve të mëposhtme:

- NËXTJES SË PROKURIMIT TË GJELBËR DHE SOCIAL;
- PËRMIRËSIMIT TË SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK.

### 2.1. OBJEKTIVI SPECIFIK 1 – NËXTJA E PROKURIMIT TË GJELBËR DHE SOCIAL

#### **Konteksti**

Prokurimi i qëndrueshëm është një koncept shumë i gjerë dhe përfshin një sërë fushash ku prokurimi publik mund të luajë një rol të rëndësishëm në realizimin e qëllimeve të politikave të ndryshme sociale dhe mjedisore me natyrë horizontale. Gjithsesi, këto politika jo domosdoshmërisht lidhen me mallrat, punët apo shërbimet që prokurohen dhe për këtë arsye përfshirja e kriterëve që lidhen me to në procedurat e prokurimit është e limituar.

Këto mund të përfshijnë promovimin e mundësive të barabarta për të dizavantazuarit për arsye gjinore ose etnike; promovimin e standardeve të punës; promovimin e mundësive për punësim për personat të cilët janë të papunë prej një kohe të gjatë ose mbështetjen për njerëzit me aftësi të kufizuara. Më së shumti, prokurimi publik është përdorur për të mbështetur objektivat mjedisore, si p.sh., adresimi i ndryshimeve klimatike ose ruajtja e biodiversitetit. Politikat mjedisore mund të jenë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, si p.sh., eficienta e energjisë.

#### **Objektivi**

Zgjerimi i përdorimit të objektivave të qëndrueshëm në sistemin e prokurimit.

Objektivi i mësipërm është parashikuar të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

#### **MASA 2.1.1. PËRMIRËSIMI I KUADRIT LIGJOR LIDHUR ME PËRDORIMIN E KRITERËVE MJEDISORE DHE SOCIALE**

Kjo masë parashikohet të realizohet nëpërmjet hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore në linjë me zhvillimet më të fundit të *acquis* të BE-së në fushën e prokurimeve publike, përfshirë sektorin e energjisë, mjedisit dhe ndryshimeve klimaterike.

Institucionet përgjegjëse:

Ministria përgjegjëse për energjinë, APP-ja, ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale, ministria përgjegjëse për mjedisin.

Treguesit e performancës:

- hartimi dhe miratimi i amendimeve ligjore përkatëse lidhur me eficiencën e energjisë;
- hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në linjë me zhvillimet e reja të *acquis* të BE-së për

prokurimin mjedisor dhe social;

- hartimi dhe miratimi i udhërrëfyesit për përdorimin e kriterit të tenderit ekonomikisht më të favorshëm bazuar në kosto (MEAT).

#### MASA 2.1.2. TRAJNIME DHE MATERIALE NDIHMËSE

Përdorimi i kriterëve që synojnë prokurimin e qëndrueshëm kërkojnë një staf të trajnuar dhe të përgatitur me njohuritë për realizimin e kësaj mase.

Institucione përgjegjëse:

APP-ja, ministria përgjegjëse për energjinë, ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale, ministria përgjegjëse për mjedisin, ASPA.

Treguesit e performancës:

- trajnim i stafit të APP-së dhe AK-së për përdorimin e kriterëve mjedisorë që lidhen me mbrojtjen e mjedisit në procedurat e prokurimit;

- ngritja e kapaciteteve dhe përgatitja për prokurimin e shërbimeve sociale, si dhe trajnimi i stafit të APP-së dhe AK-së për prokurimin e shërbimeve sociale;

- organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere lidhur me përdorimin e kriterëve sociale;

- përgatitja e materialeve ndihmëse, udhëzimeve, udhërrëfyesve etj.

## 2.2 OBJEKTIVI SPECIFIK 2 – PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK

### **Konteksti**

Sistemi elektronik i prokurimit është funksional në Shqipëri që në vitin 2009. Gjatë gjithë këtyre viteve, SPE-ja ka pësuar përmirësime madhore, duke përfshirë funksionalitete dhe module të rëndësishme jo vetëm për të përmirësuar performancën e sistemit elektronik, por edhe performancën e sistemit të prokurimit në tërësi.

Aktualisht, çdo komunikim lidhur me procesin e prokurimit publik kryhet nëpërmjet komunikimit elektronik dhe çdo procedurë kryhet në sistemin e prokurimit elektronik.

Funksionimi i duhur i sistemit elektronik është thelbësor për të garantuar performancën dhe eficiencën e prokurimit publik në Shqipëri.

Për këtë arsye, përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit është shumë i rëndësishëm, me qëllim, jo vetëm përmirësimin e funksionimit të sistemit elektronik, por edhe garantimin e transparencës dhe të përputhshmërisë me praktikën më të mira ndërkombëtare. Ndër zhvillimet më të rëndësishme, në lidhje me sistemin do të jetë përdorimi i teknologjisë së avancuar të inteligjencës artificiale dhe proceseve të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane, në procedurat e prokurimit publik.

Për sa u përket aspekteve të ndryshme të zhvillimit të procedurës së prokurimit nëpërmjet sistemeve elektronike, ndryshimet e nevojshme vijnë në kuadër të rritjes të transparencës dhe eficiencës në procedurat e prokurimit. Në kuadër të zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit në fushën e shërbimeve publike, me qëllim lehtësimin e procedurave, rritjen e transparencës dhe shmangien e konfliktit të interesit është e domosdoshme të përfshihet në këtë zhvillim teknologjik edhe procesi i prokurimit publik.

Në kuadër të rritjes së transparencës dhe eficiencës, disa procese të prokurimit publik, sikurse janë: përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, studimi i tregut, hartimi i specifikimeve teknike do të jenë më eficiente dhe efektive duke u kryer në sisteme elektronike të certifikuara, të cilat ndërveprojnë me sisteme të tjera përmes Platformës Qeveritare të Ndërveprimit dhe sisteme të tjera që do të vlerësohen se janë të domosdoshme për procesin. Për këtë qëllim, SPE do të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

Me qëllim rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë në procesin e vlerësimit është e nevojshme kryerja e vlerësimit automatik të plotësimit të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të ofertuesve për fazën e parë të parakualifikimit, si dhe zhvillimit të sistemit dinamik të blerjes dhe

ankandit elektronik, duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara.

### **Objektivi**

Rritja e performancës të sistemit të prokurimit elektronik.

Objektivi i mësipërm është parashikuar të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

#### **MASA 2.2.1. PËRMIRËSIME TË BAZËS LIGJORE**

Zhvillimi i sistemit të prokurimit elektronik me përdorim të teknologjisë të avancuar artificiale me procese të automatizuara dhe me ndërveprime me sisteme të tjera.

Amendimet ligjore synojnë ndër të tjera përmirësimin e funksionimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik.

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja, AKSHI.

Treguesit e performancës:

- hartimi dhe miratimi i amendimeve të akteve ligjore dhe nënligjore;
- hartimi dhe publikimi në faqen e APP-së i manualeve të ndryshme teknike për përdorimin e sistemit, të cilat do t'u vijë në ndihmë të gjithë përdoruesve;
- hartimi dhe miratimi i amendimeve të formularëve standardë për publikimin e njoftimeve (në mënyrë që të përshtaten me rregulloren zbatuese të komisionit 2022/2303 dhe të sigurojnë publikimin e tyre në platformën ditore elektronike të tenderëve (TED)).

#### **MASA 2.2.2. PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË PROKURIMIT ELEKTRONIK**

Rritja e performancës së sistemit elektronik të prokurimit dhe funksionimi i duhur i sistemit elektronik është thelbësor për të garantuar performancën dhe eficiencën e prokurimit publik në Shqipëri. Për këtë, është e nevojshme që të ndërmerren masa të mëtejshme, me qëllim rritjen e aksesimit dhe bërjen më të përdorshëm të tij. Për këtë arsye, përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit është shumë i rëndësishëm, me qëllim, jo vetëm përmirësimin e funksionimit të sistemit elektronik, por edhe garantimin e transparencës e të përputhshmërisë me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Disa procese të prokurimit publik, si përlllogaritja e vlerës limit të kontratës, studimi i tregut, hartimi i specifikimeve teknike duhet të kryhen në sisteme elektronike të certifikuara, mbështetur në ndërveprim me sisteme të tjera të Platformës Qeveritare të Ndërveprimit. Për këtë qëllim, Sistemi i Prokurimit Elektronik do të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

Gjithashtu, kryerja e vlerësimit automatik të plotësisht të të gjitha kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të ofertuesve për fazën e parë të parakualifikimit ose një pjesë e tyre, si dhe zhvillimi i sistemit dinamik të blerjes, ankandit elektronik dhe katalogut elektronik, duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara do të rrisin efektivitetin, eficiencën, performancën dhe saktësinë e procesit.

Institucione përgjegjëse:

AKSHI, APP-ja.

Treguesit e performancës:

- ndërveprimi i sistemit të prokurimit elektronik me sisteme të tjera publike, të cilat do të lehtësojnë procesin e prokurimit publik;
- ndërlidhja me SPE-në dhe përdorimi i sistemit për menaxhimin e kontratës;
- bërja plotësisht funksional i sistemit dinamik të blerjes;
- RED FLAGS/shtimi i funksionaliteteve të flamurit të kuq në Sistemin e Prokurimit Elektronik për shmangien e praktikave korruptive;
- shtimi i funksionaliteteve në sistem për evidentimin e përdorimit të kriterëve mjedisore dhe sociale;
- përdorimi i teknologjisë së avancuar të inteligjencës artificiale dhe proceseve të robotizuara;

- ngritja e sistemit të “*e-Cataloghne*” (Katalogu elektronik).

### 3. QËLLIMI I POLITIKËS 3 – INTEGRITETI DHE LIGJSHMËRIA E PROCESIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit, i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesionet/partneritetet publike private dhe prokurimet e mbrojtjes e të sigurisë, si dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me ligj dhe akte të tjera juridike në kuadër të kompetencave të saj.

Me qëllim garantimin e një sistemi prokurimi eficient dhe efektiv është e nevojshme marrja e një sërë masash, sidomos sa u takon aspekteve të mëposhtme:

- SIGURIMI I INTEGRITETIT NË PROCESIN E PROKURIMIT PUBLIK;
- SIGURIA LIGJORE E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE;
- FORCIMI I MEKANIZMAVE KONTROLLUES.

#### 3.1. OBJEKTIVI SPECIFIK 1 – SIGURIMI I INTEGRITETIT NË PROCESIN E PROKURIMIT PUBLIK

##### **Konteksti**

Lufta kundër korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të paligjshme në fushën e prokurimit publik është pjesë integrale e strategjisë për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik.

Në kuadër të ruajtjes së integritetit të procedurave të prokurimit, APP-ja ka nënshkruar memorandume mirëkuptimi me ILDKPKI-në, me Autoritetin e Konkurrencës, Prokurorinë e Përgjithshme, Prokurorinë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Komisionin e Prokurimit Publik, Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale, Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve etj.

Lufta kundër korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të paligjshme në fushën e prokurimit publik do të jenë pjesë integrale e strategjisë.

##### **Objektivi**

Objektivi kryesor i këtij komponenti mbetet ulja e praktikave korruptive dhe përmirësimi i perceptimit publik ndaj praktikave korruptive në fushën e prokurimit.

Objektivi i mësipërm është parashikuar të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

##### MASA 3.1.1. ORGANIZIMI I EVENTEVE NDËRGJEGJËSUESE

Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta, si: organizimi i tavolinave të diskutimit, ndërgjegjësuese dhe trajnuese, me fokus edhe trajnime lidhur me përdorimin e teknologjive të avancuara të inteligjencës artificiale dhe proceseve të robotizuara, ku përveç stafëve respektive të institucioneve shtetërore, në fokus të jetë pjesëmarrja e autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë.

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja, Autoriteti i Konkurrencës, ILDKPKI-ja, Shkolla e Magjistraturës, KLSH-ja, struktura të tjera audituese.

Treguesit e performancës:

- ngritja e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit për integritetin në fushën e prokurimit publik;
- realizimi i takimeve dypalëshe, seminareve dhe *workshop*-eve me synim ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit për integritetin në fushën e prokurimit publik;
- organizimi i eventeve ndërgjegjësuese, *workshop*-eve, konferencave mbi marrëveshjet në oferta. Rritja e konkurrencës dhe ndërgjegjësimit lidhur me procedurat me një ofertë të kualifikuar, kërkesat e kualifikimit dhe specifikimet teknike;
- punonjës të trajnuar për integritetin.

##### MASA 3.1.2 PËRGATITJA E MATERIALEVE PËR RRITJEN E NDËRGJEGJËSIMIT

Lufta kundër korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të paligjshme në fushën e prokurimit publik është pjesë integrale e strategjisë për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik. Do të organizohen sisteme rregullatore dhe institucionale për arritjen e objektivave të politikës shumë të rëndësishme duke

garantuar vlerën për paratë dhe integritetin në ofrimin e shërbimeve publike.

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Treguesit e performancës:

- dokument i përbashkët APP-ILDKPKI për integritetin e punonjësve në prokurimin publik;
- përfshirja e risqeve dhe e masave të lidhura me prokurimin publik në manualin e integritetit dhe në planet e integritetit, si pjesë e Strategjisë kundër Korrupsionit.

### MASA 3.1.3. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Lufta kundër korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të paligjshme në fushën e prokurimit publik është pjesë integrale e strategjisë për përmirësimin e sistemit të prokurimit publik. Një sërë aktiviteteve shumë të rëndësishme parashikohen për arritjen e objektivave të politikës duke garantuar vlerën për paratë dhe integritetin në ofrimin e shërbimeve publike.

Institucionet përgjegjëse:

APP-ja, ministria përgjegjëse për antikorrupsionin.

Treguesit e performancës:

- Marrëveshja e bashkëpunimit midis ministrisë përgjegjëse për antikorrupsionin (në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit) dhe Agjencisë së Prokurimit Publik, duke synuar forcimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve me DPA-APP, për bashkëpunim eficient dhe mbarëvajtje të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik;

- Shkëmbim informacioni midis DPA-it dhe APP-së për raste të denoncimit të korrupsionit ndaj njësisë të prokurimit publik pranë autoriteteve publike. Ngritja e ekipeve të përbashkëta të verifikimit të thelluar të rasteve të denoncimeve për korrupsion ndaj njësisë të prokurimit publik. Kapacitete të shtuara për ekspertët e të dyja institucioneve në kuadër të hetimit administrativ;

- Rishikimi i metodologjisë së vlerësimit të riskut të integritetit duke përfshirë një fushë të veçantë vlerësimi, veprimtarinë e njësisë të prokurimit publik;

- Hartimi në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për antikorrupsionin i model-planit të integritetit për të gjitha autoritetet kontraktore, me fokus të veçantë integritetin e procesit të prokurimit publik;

- Seanca dhe mjete informimi për riksun e korrupsionit në sektorin e prokurimit publik;

- Fushata ndërgjegjësimi për integritetin në sektorin e prokurimeve publike.

### 3.2. OBJEKTIVI SPECIFIK 2 – SIGURIA LIGJORE E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

#### **Konteksti**

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit, i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit publik, koncesionet/partneritetet publike private dhe prokurimet e mbrojtjes e të sigurisë, si dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera juridike në kuadër të kompetencave të tij.

Shqyrtimi i ankesave është parashikuar nga ligji i prokurimit publik, i cili parashikon procesin kryesor, si dhe organin përgjegjës për shqyrtimin e ankesave dhe për marrjen e vendimit përfundimtar në këtë drejtim.

#### **Objektivi**

Krijimi i një sistemi eficient për shqyrtimin e ankesave.

Objektivi i mësipërm është parashikuar të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

### MASA 3.2.1. RRTIJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Institucioni përgjegjës:

KPP-ja.

Treguesit e performancës:

- Rritja e kapaciteteve institucionale të KPP-së nëpërmjet rritjes së kualifikimit të stafit;
- Organizimi i trajnimeve sa i përket legjislacionit të prokurimit publik, koncesioneve dhe PPP-ve dhe prokurimeve në fushën e mbrojtjes e të sigurisë;
- Miratimi i manualit të posaçëm të trajnimeve në nivel vjetor me institucionet e arsimit të lartë dhe partnerët ndërkombëtarë;
- Organizimi i trajnimeve me operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore lidhur me problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesave, me qëllim zgjidhjen e tyre.

### MASA 3.2.2. NDËRLIDHJA E SISTEMIT ELEKTRONIK TË ANKESAVE ME SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK

Sistemi elektronik i ankesave me ndryshimet e reja ligjore pritet të përmirësohet duke pasqyruar automatizim të mëtëjshëm të proceseve, nëpërmjet aplikimit të inteligjencës artificiale të procesit të punës. Gjithashtu, përmirësimi i sistemit do të sjellë përmirësim të transparencës, integritetit dhe të dhënave në përputhje me *Open Contracting Data*, duke përmirësuar edhe standardet e publikimit të veprimtarisë së KPP-së.

Institucionet përgjegjëse:

KPP-ja, APP-ja, AKSHI.

Treguesit e performancës:

- Ndërlidhja e sistemit të ankesave elektronike me sistemin e prokurimit elektronik dhe automatizimi i proceseve, nëpërmjet inteligjencës artificiale të procesit të punës së KPP-së;
- Përmirësimi i transparencës, integritetit dhe të dhënave, sipas *Open Contracting Data Standard*, si dhe sipas standardeve evropiane, nëpërmjet përmirësimit të standardeve të publikimit të veprimtarisë së KPP-së;
- Automatizimi i procesit të vendimmarrjes së KPP-së.

### 3.3. OBJEKTIVI SPECIFIK 3 – FORCIMI I MEKANIZMAVE KONTROLLUES

#### **Konteksti**

Procesi i prokurimit publik sot është një proces transparent, i aksesueshëm nga palët e interesuara, dhe që ofron një informacion gjithëpërfshirës, plotësuar kjo edhe nga respektimi i plotë i standardeve lidhur me procedurat e rishikimit.

APP-ja është institucioni përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë së sistemit të prokurimit publik. Aktualisht, ky rol monitorues po kryhet në tri mënyra:

- i. Ofrimin e asistencës së vazhdueshme për autoritetet kontraktuese gjatë përgatitjes së dokumenteve të tenderit dhe dhënien e rekomandimeve, me qëllim shmangien e vendosjes së kriterëve që mund të jenë diskriminuese ose shtrembëruese të konkurrencës.
- ii. Monitorimi *ex-post* i procedurave të prokurimit, kryesisht me nismën e APP-së, nëpërmjet hartimit të planeve të verifikimit, reklamim nga të tretët ose nëpërmjet rishikimit të raporteve të auditimit të dërguara në APP nga institucionet e auditimit.
- iii. Monitorimi i zbatimit të kontratave, nëpërmjet planeve të zbatimit të kontratës pas nënshkrimit të kontratës, si dhe raporteve periodike e përfundimtare të zbatimit, të dërguara në APP nga AK-ja.

#### **Objektivi**

APP-ja do të vazhdojë rolin e saj proaktiv në asistimin e AK-së në hartimin e dokumenteve të tenderit, nxjerrjen e udhëzimeve, rekomandimeve dhe njoftimeve për aspekte të ndryshme të procedurave të prokurimit publik, si dhe verifikimin *ex post* të ligjshmërisë së procedurës dhe monitorimit të kontratës.

Objektivi i mësipërm është parashikuar të realizohet nëpërmjet masave të mëposhtme:

#### MASA 3.3.1. ASISTENCA PARAPRAKE E AUTORITETEVE KONTRAKTORE

APP-ja jep këshilla dhe asistencë në fushën e prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik. APP-ja asiston autoritetet kontraktore në hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, veçanërisht në hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, lidhur me

procedurat e prokurimit të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), si dhe duke asistuar çdo kërkesë paraprake të paraqitur nga autoritetet kontraktore përpara publikimit në SPE.

Institucione përgjegjëse:

APP-ja, AK-ja.

Treguesit e performancës:

- procedura prokurimi të asistuar nga APP-ja;
- rekomandime të marra parasysh nga AK-ja.

### MASA 3.3.2. VERIFIKIMI I ZBATIMIT TË LIGJSHMËRISË SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK

APP-ja verifikon zbatimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit ose anulimit të procedurës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara ligjin nr. 162/2020 dhe aktet nënligjore. Procesi i verifikimit iniciohet *ex-officio*, kryesisht, me nismën e APP-së, nëpërmjet hartimit të planeve të verifikimit; nëpërmjet reklamimit nga të tretët apo komunikimit shkresor me autoritete të ndryshme kontraktore; indicie nga raportet e organeve audituese apo nga institucione të tjera etj.

Institucione përgjegjëse:

APP-ja, AK-ja.

Treguesit e performancës:

- plan-verifikimi/monitorimi për procedurat e prokurimit;
- procedura prokurimi të verifikuara nga APP-ja;
- verifikimi i indicieve nga raportet përfundimtare të organeve audituese;
- vendime të APP-së, masa administrative, raportime.

### MASA 3.3.3. MONITORIMI I EKZEKUTIMIT TË KONTRATAVE

Sistemi elektronik i menaxhimit të kontratave është zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) me synimin për të mundësuar menaxhimin e kontratave për autoritetet kontraktore dhe/ose institucionet përfituese dhe ndjekja e tyre gjatë gjithë ciklit jetësor të një kontrate. Aktualisht sistemi po pilotohet nga AKSHI për kontratat e veta.

Institucione përgjegjëse:

APP-ja, AKSHI, ministria përgjegjëse për financat, autoritetet kontraktore për kontratat respektive.

Treguesit e performancës:

- disponueshmëria për përdorim në çdo kohë e sistemit të menaxhimit të kontratave nga autoritetet kontraktore;
- numri i planeve të zbatimit të kontratave të hartuara dhe të ngarkuara nga autoritetet kontraktore;
- planset e monitorimit të kontratave dhe numri i planeve të zbatimit të kontratave të monitoruara nga autoritetet kontraktore.

## PJESA E TRETË

### ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, RAPORTIMI DHE KOORDINIMI

#### 3.1. PËRGJEGJËSIA INSTITUCIONALE

Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 u realizua nga një grup ndërinstytucional pune, i përbërë nga të gjitha institucionet që veprojnë në fushën e prokurimit, bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 77, datë 27.6.2023, “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj 2024–2027”.

Grupi ndërinstytucional si dhe të gjithë aktorët e përfshirë në konsultime dhanë komente të vlefshme, duke e rishikuar disa herë draftin e përgatitur, me qëllim miratimin e një Strategjie

gjithëpërfshirëse, ku secili të gjejë veten e të japë kontributin e tij në garantimin e një menaxhimi sa më të mirë të fondeve publike dhe ofrimin e shërbimeve publike sa më cilësore. Grupi ndërinstitucional është asistuar edhe nga SIGMA gjatë procesit të hartimit të strategjisë dhe planit të saj të veprimit.

Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë është përcaktuar në planin e veprimit të paraqitur në aneksin 1 dhe ndahet ndërmjet APP-së, institucioneve të tjera dhe aktorëve të tjerë. Për shkak të natyrës së masave, duhet të ekzistojë një bashkërendim i mirë, duke shprehur gatishmëri për të kontribuar te zbatimi i Strategjisë. Disa masa dhe aktivitete do të jenë ndërsektoriale dhe ndërinstitucionale dhe kërkojnë angazhim apo bashkëpunim me institucione përtej sistemit të prokurimit publik, siç janë masat dhe aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit, aneksi 1.

KPP-ja do të luajë një rol kryesor në çështjet që lidhen me rishikimin e ankesave, ndërsa përgjegjësitë që kanë të bëjnë me koncesionet dhe PPP-të do të jenë nën fushën e përgjegjësisë së ATRAKO-s. Për më tepër, OBP-ja do të jetë institucioni që do të merret me zbatimin e masave që lidhen me prokurimin e përqendruar.

Disa aktivitete do të kërkojnë bashkëpunim ndërmjet aktorëve përkatës në sistemin e prokurimit publik, duke përfshirë autoritetet kontraktore, operatorët ekonomikë dhe shoqatat e tyre të biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat etj.

### **3.1. MONITORIMI DHE RAPORTIMI**

Monitorimi i zbatimit të SKPP 2024–2030 është një proces tejet mase shumë i rëndësishëm pasi siguron që implementimi i politikave të pasqyruara në këtë dokument të ndiqen hap pas hapi nga të gjithë aktorët në mënyrë permanente dhe të vazhdueshme.

Monitorimi duhet kuptuar si proces që synon të sigurojë informacion për APP-në dhe palët e interesuara për progresin drejt arritjes së objektivave specifike. Ai do të bazohet në një sistem të mbledhjes së informacionit dhe analizës së treguesve të monitorimit. Monitorimi nënkupton mbledhjen në vazhdimësi të të dhënave në lidhje me Strategjinë, si të atyre statistikore, ashtu edhe të dhënave tjera që japin informacion për zbatimin e Strategjisë. Në pasaportat e indikatorëve (aneksi 2), për secilin tregues është përcaktuar përgjegjësia për mbledhjen e të dhënave, ndërsa roli mbikëqyrës dhe koordinues i takon sektorit të politikave strategjike dhe statistikave.

Vlerësimi është procesi më i hollësishëm i analizës së suksesit në zbatimin të Strategjisë, duke identifikuar se çfarë ka shkuar mirë, duke shqyrtuar arsyet se çfarë nuk ka shkuar mirë dhe pastaj duke ripërshtatur drejtimin strategjik në varësi të rrethanave. Projektimi dhe ekzekutimi i fazës së vlerësimit zakonisht është i pavarur nga korniza e zakonshme e monitorimit dhe raportimit.

Raportimi, monitorimi dhe vlerësimi do të përbëjnë një pjesë të rëndësishme të ciklit të tyre. Për një monitorim dhe vlerësim cilësor të këtij plani, është i domosdoshëm një bashkëpunim dhe mirëkoordinimin midis aktorëve. Procesit i monitorimit dhe vlerësimit do të kalojë përmes disa fazave si: i. mbledhja e të dhënave; ii. analizimi i të dhënave; iii. raportimi dhe llogaridhënia.

Përbërja, rolet dhe përgjegjësitë e strukturës drejtuese janë detajuar, si më poshtë:

#### **- Komiteti Drejtues i Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik**

Komiteti Drejtues i SKPP-së është struktura mbikëqyrëse përgjegjëse për drejtimin dhe monitorimin e aktiviteteve të këtij dokumenti. Ai do të kryesohet nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik dhe anëtarësia e tij do të jetë, si më poshtë:

- Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik, kryetar;
- Drejtori i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave Strategjike dhe Integritetit, Agjencia e Prokurimit Publik, sekretar;
- Kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik, anëtar;
- Kryetari i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve, anëtar;
- Një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga Ministria e Mbrojtjes, anëtar;
- Një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga Ministria e Brendshme, anëtar;

- Një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për financat; anëtar;
- Një përfaqësues i nivelit të lartë drejtues nga ministria përgjegjëse për ekonomisë, anëtar;
- Administratori i Operatorit të Blerjeve të Përqendruara, anëtar;

KD-ja do të mbledhet çdo gjashtë muaj për të shqyrtuar progresin e reformave, të rishikojë risqet dhe të miratojë masa lehtësuese. Herë pas here mund të ftojë persona të tjerë në KD në varësi të çështjeve që janë për shqyrtim.

Përgjegjësitë e KD-së renditen, si më poshtë vijon:

- Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së PP-së kundrejt objektivave të synuar dhe treguesve të performancës dhe miratimi i raporteve gjashtëmujore dhe njëvjeçare;
- Shqyrtimi i arritjeve, risqeve dhe problematikave për secilin qëllim të politikave dhe përcaktimi i masave për adresimin e tyre;
- Bashkëpunimi me institucione të tjera për të garantuar zbatimin e masave dhe përmbushjen e objektivave të SKPP-së;
- Në bashkëpunim me Grupin Koordinues të SKPP rishikon objektivat dhe planin e veprimit.

Raportet e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik, të miratuara nga KD-ja, publikohen në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

#### **- Grupi Koordinues i Strategjisë Kombëtare për PP-në**

Do të krijohet Grupi Koordinues për Zbatimin e SKPP, i cili do të drejtohet nga APP-ja, dhe përbëhet nga zyrtarë përgjegjës të APP-së dhe të institucioneve të tjera përkatëse. Grupi koordinues koordinon dhe monitoron zbatimin e planit të veprimit dhe vlerëson mbi baza të vazhdueshme progresin e objektivave. Shërbimet e sekretarisë për Grupin Koordinues do të ofrohen nga sektori i politikave strategjike dhe statistikave. Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit Koordinues ndër të tjera janë:

- Analiza e progresit në zbatimin e SKPP-së, në bazë të kontributeve të mbledhura;
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave plotësuese për të siguruar zbatimin e SKPP-së.

Takimet e Grupit Koordinues do të mbahen të paktën 2 herë në vit dhe, sipas nevojës, do të ftohen edhe pjesëmarrës të tjerë.

#### **- Sekretariati teknik i Strategjisë Kombëtare për PP-në**

Sektori i zbatimit të politikave strategjike dhe statistikave do të shërbejë si sekretariat teknik për KD-në e SKPP-së. Përgjegjësitë e sekretariatit teknik (ST) janë renditur më poshtë:

- Të sigurojë të gjithë mbështetjen teknike për menaxhimin e procesit për funksionimin e KD-së dhe Grupit Koordinues;
- Të bashkërendojë punën midis institucioneve të përfaqësuara në KD, institucioneve të pavarura, grupeve të interesit etj.;
- Të organizojë takime të KD-së dhe grupit koordinues dhe të parashtrijë çështje diskutimi të përgatitura në bashkëpunim me anëtarët dhe palët e tjera të interesuara;
- Të përgatisë listën e anëtarëve të përhershëm dhe të ftuarve të tjerë për grupin përkatës;
- Të organizojë agjendën, takime dhe aktivitete të tjera sekretariale;
- Të përgatisë raporte periodike (6-mujore dhe vjetore), në lidhje me monitorimin e zbatimit të Strategjisë, bazuar në raportimet e dërguara nga institucionet përgjegjëse;
- Të kryejë çdo detyrë tjetër të caktuar nga KD-ja, në përmbushje të përgjegjësisë së tij.

## **PJESA E KATËRT**

### **PLANI I VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM**

Vlerësimi i nevojave financiare për zbatimin e SKPP-së prezanton në mënyrë të detajuar efektet financiare që do të ketë zbatimi i strategjisë, duke përcaktuar shpenzimet shtesë që do të sillte në buxhetin e secilit institucion zbatimi i secilit aktivitet. Për të mbajtur të pastër efektin shtesë nuk janë llogaritur shpenzimet administrative (paga të stafit, shpenzime operacionale dhe mirëmbajtjeje) të

institucioneve publike të përfshira në zbatimin e strategjisë, veç rasteve kur një institucion do të ketë ristrukturime ose shtim të stafit. Kjo qasje bazohet në metodologjinë e vlerësimit financiar që kërkon vlerësimin sa më qartë të efektit shtesë në buxhetin e secilit institucion.

Nevoja financiare të nevojshme për zbatimin e veprimeve të SNRAP gjatë periudhës kohore prej 2023–2027 parashikohet të jetë në nivelin **3,562.3 milionë lekë ose 34.48 milionë euro**<sup>1</sup>.

*Tabela 2: Kostoja e zbatimit të strategjisë sipas qëllimeve të politikës*


Objektivat specifikë	Kostoja në lek	Kostoja në EUR	%
<b>Qëllimi i politikës 1 – Procesi i prokurim publik eficient dhe efektiv</b>			
1.1 Objektivi specifik: Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor	3,780,780	36,600	
1.2 Objektivi specifik: Forcimi i kapaciteteve institucionale	5,602,992	54,240	
1.3 Objektivi specifik: Përmirësimi i blerjes së përqendruar	225,984,896	2,187,656	
1.4 Objektivi specifik: Fuqizimi i kapaciteteve zbatuese	2,517,067	24,367	
<b>Kostoja totale: Qëllimi i politikës I</b>	<b>237,885,735</b>	<b>2,302,863</b>	<b>6.68%</b>
<b>Qëllimi i politikës 2 – Prokurimi i qëndrueshëm dhe inovativ</b>			
Objektivi 2.1: Nxitja e prokurimit të gjelbër dhe social	0	0	
Objektivi 2.2: Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik	3,321,095,000	32,150,000	
<b>Kosto totale: Qëllimi i politikës II</b>	<b>3,321,095,000</b>	<b>32,150,000</b>	<b>93.23%</b>
<b>Qëllimi i politikës 3 – Integriteti dhe ligjshmëria e prokurimeve publike</b>			
Objektivi 3.1: Sigurimi i integritetit në procesin e prokurimit publik	2,720,922	26,340	
Objektivi 3.2: Siguria ligjore e shqyrtimit të ankesave	613,602	5,940	
Objektivi 3.3: Forcimi i mekanizmave kontrollues	0	0	
<b>Kostoja totale: Qëllimi i politikës III</b>	<b>3,334,524</b>	<b>32,280</b>	<b>0.09%</b>
<b>Kostoja totale</b>	<b>3,562,315,259</b>	<b>34,485,143</b>	<b>100%</b>

Siç shihet nga të dhënat në tabelat 2, peshën specifike më të madhe e zënë shpenzimet për zbatimin e aktiviteteve në qëllimin e politikës “Qëllimi i politikës 2 – Prokurimi i qëndrueshëm mjedisor, social dhe inovativ”, i cili zë edhe 93.23% të totalit të koston së vlerësuar për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë, specifikisht objektivi specifik 2.2: Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik, që përfshin kostot për përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik.

Në aspektin e shpenzimeve sipas klasifikimit ekonomik, tabelat 2 dhe 3 më poshtë paraqesin në mënyrë të detajuar shpenzimet e nevojshme, sipas të tria kategorive, paga, shërbime dhe investime kapitale. Pjesën më të madhe të shpenzimeve të vlerësuara e zënë shpenzimet aktive të patrupëzuara pasi këtu përfshihet kostoja e asistencës teknike të nevojshme për realizimin e aktiviteteve sidomos ato që lidhen me rishikimin e legjislacionit dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve që merren me zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik.

<sup>1</sup> Sipas lidhjes 3, “Vlerësimi i detajuar i koston për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Prokurimit Publik 2023–2027”

Tabela 3 dhe grafiku 1: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike ( 000 lek)




Gati gjysma e planit të aktiviteteve të strategjisë, 58% (14 ndaj 24 në total), do të realizohet me vetë kapacitetet njerëzore dhe administrative të strukturave institucionale të përfshira në zbatimin e strategjisë dhe për 10 aktivitete vlerësohet i domosdoshëm mobilizimi i burimeve financiare dhe burimeve njerëzore shtesë.

Pjesa më e madhe e shpenzimeve kërkohet në dy vitet e para të realizimit të planit të veprimit. Kjo kërkon edhe një planifikim të shpenzimeve për këtë periudhë.

Buxheti i shtetit do të mbulojë rreth 6.58% të koston shtesë nga zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit. Asistenca teknike parashikohet të ofrohet nga donatorë të ndryshëm si Bashkimi Evropian, nëpërmjet SIGMA/OECD dhe Banka Botërore. Boshllëku financiar është në masën 0.05%.

Grafiku 2: Boshllëku financiar



Duhet theksuar se përcaktimi i financimit nga SIGMA/OECD nëpërmjet programeve të financuara nga Bashkimi Evropian është përcaktuar bazuar në mbështetjen e kaluar të ofruar nga ky institucion. Përcaktimi i saktë i mbështetjes do të jetë subjekt i diskutimeve midis APP-së dhe SIGMA/OECD.

Pjesa më e madhe e financimit të huaj i përket edhe objektivit specifik 1.52.2: Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik, që përfshin kostot për përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik dhe që lidhet me investimin që qeveria parashikon të kryejë për përmirësimin e sistemit të prokurimit elektronik. Aktualisht, po kryhen bisedimet me Bankën Botërore, që ky investim të financohet nga Banka Botërore. Për këtë arsye edhe në strategji ky objektivi paraqitet i mbuluar me financim.

ANEKS 1  
PLANI I VEPRIMIT

Plani i aktiviteve 2024-2027								
Nr. i objektivit	Detajimi i objektivit	Aktivitetet			Institucioni përgjegjës	Institucioni bashkëpunues	Data e fillimit	Data e mbarimit
		Nr. i aktivitetit	Detajimi i aktivitetit	Treguesi i matjes në nivel produkti ( <i>output</i> )				
1	2	3	4	5	6	7	8	9
<b>QËLLIMI I POLITIKËS 1 – PROCESI I PROKURIM PUBLIK EFICIENT DHE EFEKTIV</b>								
Objektivi 1.1	Përmirësimi i mëtejshëm i kuadrit ligjor	Aktiviteti 1.1.1	Rishikimi i ligjit të prokurimit publik	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Analiza e legjislacionit;</li> <li>✓ Tabela e përputhshmërisë;</li> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i amendimeve të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” në Kuvend;</li> </ul>	APP	KPP AKSHI	TM II 2023	TM II 2024
		Aktiviteti 1.1.2	Rishikimi i akteve nënligjore në përputhje me ligjin e prokurimeve publike	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i amendimeve të vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar;</li> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i VKM-së së veçantë lidhur me kufijtë monetarë</li> </ul>	APP		TM II 2024	TM IV 2024
		Aktiviteti 1.1.3	Përmirësimi i kuadrit ligjor të koncesioneve dhe PPP	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Analiza e legjislacionit;</li> <li>✓ Tabela e përputhshmërisë;</li> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i kuadrit të ri ligjor në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve në Kuvend;</li> <li>✓ Përmirësimi i rolit politikëbërës të ATRAKO-s</li> </ul>	ATRAKO, ministria përgjegjëse për financat;	APP	TM II 2023	TM IV 2024
		Aktiviteti 1.1.4	Miratimi i akteve nënligjore në fushën e koncesioneve dhe partneritet publik privat	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor sekondar në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve</li> </ul>	ATRAKO, Ministria përgjegjëse për financat;	APP	TM IV 2024	TM IV 2025
		Aktiviteti 1.1.5	Përmirësimi i kuadrit nënligjor në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i amendimeve në legjislacionin dytësor përkatës në zbatim të ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.</li> </ul>	MM, MB, AKSIK	APP	TM I 2024	TM IV 2026
		Aktiviteti 1.1.6	Procesi i aderimit në GPA-OBT	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Finalizimi dhe dorëzimi i ofertës së parë ekonomike në Sekretariatit e GPA,</li> <li>✓ Aderimi i Shqipërisë në GPA-OBT</li> </ul>	APP, ministria përgjegjëse për financat;		TM I 2023	TM IV 2027
		Aktiviteti 1.2.1	Trajnimi i stafeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Plani i trajnimit të stafeve</li> <li>✓ Organizimi i 10 (dhjetë) trajnimeve të punonjësve;</li> </ul>	APP, ATRAKO, MB, MM,		TM II 2024	TM IV 2027

Objektivi 1.2	Forcimi i kapaciteteve institucionale				KPP, OBP, ministra përgjegjëse për financat; ministra përgjegjëse për ekonominë			
		Aktiviteti 1.2.2	Forcimi i kapacitetit të ATRAKO-s	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Miratimi i strukturës organike të ATRAKO-s;</li> <li>✓ Rritja e numrit të stafit</li> <li>✓ Organizimi i 8 (tetë) trajnimeve të zhvilluara për stafin e ATRAKO-s</li> </ul>	ATRAKO; ministra përgjegjëse për ekonominë	APP për sa i takon trajnimeve	TM I 2024	TM IV 2027
Objektivi 1.3	Përmirësimi i blerjes së përqendruar	Aktiviteti 1.3.1	Ngritja e Operatorit të Blerjes së Përqendruar SHA	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Miratimi i strukturës dhe organikës së re të OBP-së;</li> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore;</li> <li>✓ Rekrutimi i stafit</li> <li>✓ Bërja funksionale dhe operimi i OBP-së</li> </ul>	OBP, ministra përgjegjëse për ekonominë	APP	TM I 2024	TM IV 2024
		Aktiviteti 1.3.2	Përmirësimi i eficiencës së prokurimeve	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Organizimi i 3 trajnimeve të zhvilluara</li> <li>✓ Zhvillimi i procedurave të prokurimit</li> </ul>	OBP, ministra përgjegjëse për shëndetësinë; AKSHI, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	APP ASPAs	TM I 2024	TM IV 2027
Objektivi 1.4	Fuqizimi i kapaciteteve zbatuese	Aktiviteti 1.4.1	Profesionalizimi i funksionit të prokurimit publik	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ MoU me ASPA</li> <li>✓ MoU me DAP</li> <li>✓ Plani i trajnimit për nëpunësit e administratës shtetërore të përfshirë në këtë proces;</li> <li>✓ Organizimi i 20 trajnimeve të zhvilluara;</li> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i amendimeve të akteve nënligjore në kuadër të rishikimit të kriterëve specifike dhe të përshkrimit të punës për nëpunësit e prokurimit publik që janë nëpunës civil</li> </ul>	APP, ASPAs, DAP		TM I 2024	TM IV 2027
		Aktiviteti 1.4.2	Rritja e Ndërgjegjësit	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Publikimi në faqen e APP-së i udhëzimeve, rekomandimeve, njoftimeve, dhe udhërrëfyesve</li> <li>✓ Hartimi dhe publikimi në faqen e APP-së i komentarit të ligjit nr. 162/2020</li> </ul>	APP	KPP	TM I 2024	TM IV 2027
<b>QËLLIMI I POLITIKËS 2 – PROKURIMI I QËNDRUESHËM DHE INOVATIV</b>								
Objektivi 2.1	Nxitja e prokurimit të gjelbër dhe social	Aktiviteti 2.1.1	Përmirësimi i kuadrit ligjor lidhur me përdorimin e kriterëve mjedisore dhe sociale	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i amendimeve ligjore përkatëse lidhur me eficiencën e energjisë;</li> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore në linjë me zhvillimet e reja të <i>acquis</i> të BE-së për prokurimin mjedisor dhe social</li> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i udhërrëfyesit për përdorimin e kriterit të tenderit ekonomikisht më të favorshëm bazuar në kosto (MEAT).</li> </ul>	APP, ministra përgjegjëse për energinë	Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale; ministra përgjegjëse për mjedisin	TM I 2024	TM IV 2027

		Aktiviteti 2.1.2	Trajnime dhe materiale ndihmëse	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Organizimi i 2 trajnimeve të stafit të APP-së, ATRAKO-s dhe AK-së për përdorimin e kriterëve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit në procedurat e prokurimit;</li> <li>✓ Organizimi i 1 eventit ndërgjegjësues lidhur me përdorimin e kriterëve sociale</li> </ul>	APP, ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale; ministria përgjegjëse për energjinë	ASPA, ministria përgjegjëse për mjedisin	TM I 2024	TM IV 2027
Objektivi 2.2	<b>Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik</b>	Aktiviteti 2.2.1	Përmirësimet e bazës ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Hartimi dhe miratimi i akteve ligjore dhe nënligjore.</li> <li>✓ Publikimi në faqen e APP-së të manualeve të ndryshme lidhur me përdorimin e teknologjisë së avancuar të inteligjencës artificiale dhe proceseve të robotizuara</li> </ul>	APP AKSHI		TM I 2024	TM IV 2027
		Aktiviteti 2.2.2	Përmirësimi i sistemit të prokurimit elektronik	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Ndërveprimi i sistemit të prokurimit elektronik me sisteme të tjera publike;</li> <li>✓ Ndërlidhja me SPE dhe përdorimi i sistemit për menaxhimin e kontratës;</li> <li>✓ RED FLAGS / Shtimi i funksionaliteteve të flamurit të kuq në Sistemin e Prokurimit Elektronik për shmangien e praktikave korruptive;</li> <li>✓ Shtimi i funksionaliteteve në sistem për evidentimin e përdorimit të kriterëve mjedisore dhe sociale.</li> <li>✓ Përdorimi i teknologjisë së avancuar të inteligjencës artificiale dhe proceseve të robotizuara</li> <li>✓ Ngritja e sistemit të “<i>e-Catalogue</i>” (Katalogu elektronik)</li> </ul>	AKSHI	APP	TM I 2024	TM IV 2027
<b>QËLLIMI I POLITIKËS 3 – INTEGRITETI DHE LIGJSHMËRIA E PROKURIMEVE PUBLIKE</b>								
Objektivi 3.1	<b>Sigurimi i integritetit në procesin e prokurimit publik</b>	Aktiviteti 3.1.1	Organizimi i eventeve ndërgjegjësuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Organizimi i 2 takimeve me synim ngritjen e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit për integritetin në fushën e prokurimit publik;</li> <li>✓ Organizimi i 2 eventeve ndërgjegjësuese mbi marrëveshjet në oferta.</li> <li>✓ Trajnimi i 50 punonjësve për integritetin</li> </ul>	APP, Autoriteti i Konkurrencës, ILDKPKI	KLSH, struktura të tjera audituese, Shkolla e Magjistraturës,	TM I 2024	TM IV 2027
		Aktiviteti 3.1.2	Përgatitja e materialeve ndihmëse për rritjen e ndërgjegjësimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Dokument i përbashkët APP – ILDKPKI-ja për integritetin e punonjësve në prokurimin publik;</li> </ul>	APP, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,		TM I 2025	TM IV 2027
		Aktiviteti 3.1.3	Bashkëpunimi ndërinstytucional për luftën kundër korrupsionit	<ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Marrëveshja e bashkëpunimit midis ministrisë përgjegjëse për antikorrupsionin dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.</li> <li>✓ Hartimi në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për antikorrupsionin i model-planit të integritetit, për të gjitha autoritetet</li> </ul>	APP, Ministria përgjegjëse për antikorrupsionin		TM IV 2024	TM IV 2026

				kontraktore, me fokus të veçantë integritetin e procesit të prokurimit publik. ✓ Organizimi i 2 seancave vjetore të informimit për riksun e korrupsionit në sektorin e prokurimit publik.				
Objektivi 3.2	<b>Siguria ligjore e shqyrtimit të ankesave</b>	Aktiviteti 3.2.1	Rritja e kapaciteteve për shqyrtimin e ankesave	Organizimi i 5 trajnimeve ✓ Miratimi i manualit të posaçëm të trajnimeve në nivel vjetor, me institucionet e arsimit të lartë dhe partnerët ndërkombëtarë ✓ Organizimi i 3 trajnimeve me operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore lidhur me problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesave, me qëllim zgjidhjen e tyre	KPP		TM I 2024	TM IV 2027
		Aktiviteti 3.2.2	Ndërlidhja e sistemit elektronik të ankesave me Sistemin e Prokurimit Elektronik	✓ Ndërlidhja e sistemit të ankesave elektronike me sistemin e prokurimit elektronik dhe automatizimi i proceseve, nëpërmjet inteligjencës artificiale të procesit të punës së KPP-së. ✓ Përmirësimi i transparencës, integritetit dhe të dhënave, sipas <i>Open Contracting Data Standard</i> , si dhe sipas standardeve evropiane, nëpërmjet përmirësimit të standardeve të publikimit të veprimtarisë së KPP-së Automatizimi i procesit të vendimmarrjes së KPP-së;	KPP AKSHI	APP		
Objektivi 3.3	<b>Forcimi i mekanizmave kontrollues</b>	Aktiviteti 3.3.1	Asistenca paraprake e autoriteteve kontraktore	✓ Procedura prokurimi të asistuar nga APP-ja; ✓ Publikimi i rekomandimeve të nxjerra nga APP-ja	APP	AK	TM I 2024	TM IV 2027
		Aktiviteti 3.3.2	Verifikimi i zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të prokurimit publik	✓ Hartimi i planeve të verifikimit/monitorimit; ✓ Verifikimi i procedurave të prokurimit; ✓ Verifikimi i indiceve nga raportet përfundimtare të organeve audituese ✓ Publikimi i vendimeve të marra nga APP-ja dhe masave administrative të nxjerra.	APP	AK	TM I 2024	TM IV 2027
		Aktiviteti 3.3.3	Monitorimi i ekzekutimit të kontratave	✓ Përdorimi i sistemit të menaxhimit të kontratave nga autoritetet kontraktore	APP, AKSHI, ministra përgjegjëse për financat; autoritetet kontraktore për kontratat respektive			TM I 2024

ANEKS 2  
PASAPORTA E INDIKATORËVE

TITULLI I INDIKATORIT	1. PROMOVIMI I KONKURENCËS				
Objektivi përkatës	Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030				
	Qëllimi i politikës 1 – PROCESI I PROKURIMIT PUBLIK EFICIENT DHE EFEKTIV				
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Sistemi i Prokurimit Elektronik Analiza vjetore				
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia e Prokurimit Publik				
Indikatori dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.	PO				
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetor				
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë së indikatorit si dhe paraqitja e formulës së llogaritjes së indikatorit	Ndikimi do të vlerësohet: - nëpërmjet rritjes së numrit mesatar të ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit krahasuar me vitin paraardhës si dhe - nëpërmjet numrit të procedurave negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj numrit total të procedurave të prokurimit të përfunduara me fitues (procedura të tjera + negociim pa shpallje)				
Informacion mbi vlerën bazë	Viti: 2023  Viti 2023: numri mesatar i ofertave të dorëzuara në procedurat e prokurimit është 3.37 Viti 2023: numrit të procedurave negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës ndaj numrit total të procedurave të prokurimit të përfunduara me fitues (procedura të tjera +negocim pa shpallje) është 2.9% Vlera e synuar: Numri mesatar i ofertave jo më pak se 2.5% Negocimet pa shpallje jo më shumë se 10%  $\text{MoOfertave} = \frac{\text{Numri total i ofertave të dorëzuara në sistem}}{\text{Numri i procedurave ne sistem}}$  $\% \text{ e nogocim pa shpallje} = \frac{\text{Nr total i procedurave me negociim pa shpallje}}{\text{Nr total i procedurave të përfunduara me fitues}} \times 100$				
Informacion mbi vlerën e synuar	Viti:	2024	2025	2026	2027
	Vlera e treguesve				

TITULLI I INDIKATORIT	2. PROMOVIMI I PJESËMARRJES SË SME-ve NË PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK				
Objektivi përkatës	Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030				
	Qëllimi i politikës 1: PROCESI I PROKURIMIT PUBLIK EFICIENT DHE EFEKTIV				
Burimi i të dhënave për monitorimin e	Sistemi i Prokurimit Elektronik				

treguesit të performancës	Analiza vjetore				
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia e Prokurimit Publik				
Indikatori dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.	PO				
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetor				
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë së indikatorit si dhe paraqitja e formulës së llogaritjes së indikatorit	Ndikimi do të vlerësohet duke matur një rritje të përqindjes së kontratave të prokurimit publik të dhëna për SME-të në raport me vitin e kaluar $\% \text{ e SME} = \frac{\text{Numri i kontratave të dhëna për SME}}{\text{Numri Total i Kontratave të dhëna}} \times 100$				
Informacion mbi vlerën bazë	Viti: 2023				
	Viti 2023: 93.9% Vlera e synuar: Jo më pak se 50%				
Informacion mbi vlerën e synuar	Viti:	2024	2025	2026	2027
	Vlera e treguesve				

TTTULLI I INDIKATORIT	3. CILËSI MË E MIRË E MALLRAVE, PUNËVE DHE SHËRBIMEVE				
Objektivi përkatës	Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030				
	Qëllimi i politikës 1: PROCESI I PROKURIMIT PUBLIK EFICIENT DHE EFEKTIV				
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Sistemi i Prokurimit Elektronik Analiza vjetore				
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia e Prokurimit Publik				
Indikatori dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.	PO				
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetor				
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë së indikatorit si dhe paraqitja e formulës së llogaritjes së indikatorit	Ndikimi do të vlerësohet duke matur rritjen e vlerës së fituar të kontratave të dhëna bazuar në raportin më të mirë çmim/cilësi brenda kriteve të ofertës ekonomike më të favorshme (MEAT) në raport me vitin e kaluar $PQ = \frac{\text{Vlera e fituar e kontratave të dhëna bazuar në PQ}}{\text{Vlera totale total e kontratave të dhëna}} \times 100$				
Informacion mbi vlerën bazë	Viti: 2023				
	Viti 2023: Vlera 20.33% Vlera e synuar: Trend rritës				
Informacion mbi vlerën e synuar	Viti:	2024	2025	2026	2027
	Vlera e treguesve				

TTULLI I INDIKATORIT	4. RITJA E NUMRIT TË PROCEDURAVE TË REALIZUARA ME FITUES				
Objektivi përkatës	Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030				
	Qëllimi i politikës 1: PROCESI I PROKURIMIT PUBLIK EFICIENT DHE EFEKTIV				
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Sistemi i Prokurimit Elektronik Analiza e veprimtarisë së OBP-së Analiza vjetore				
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	OBP dhe APP				
Indikatori dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.	PO				
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetor				
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë së indikatorit si dhe paraqitja e formulës së llogaritjes së indikatorit	Ndikimi do të vlerësohet duke matur numrin e procedurave të prokurimit të realizuara me fitues nga OBP-ja krahasuar me vitin paraardhës.  <i>Proc përqëndruara</i> $\frac{\text{Numri i procedurave të realizuara me fitues nga OBP}}{\text{Numri total i procedurave të realizuara me fitues në rang vendi}} \times 100$				
Informacion mbi vlerën bazë	Viti: 2023				
	Viti 2023: 2.5% Vlera e synuar: Trend Rritës				
Informacion mbi vlerën e synuar	Viti:	2024	2025	2026	2027
	Vlera e treguesve				

TTULLI I INDIKATORIT	5. RITJA E PËRFITIMEVE MJEDISORE DHE SOCIALE TË SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA ORGANET PUBLIKE				
Objektivi përkatës	Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030				
	QËLLIMI I POLITIKËS 2 – PROKURIMI I QËNDRUESHËM DHE INOVATIV				
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Sistemi i Prokurimit Elektronik Analiza vjetore				
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Agjencia e Prokurimit Publik				
Indikatori dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.	PO				
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetor				
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë së	Ndikimi do të vlerësohet duke matur një rritje të procedurave të prokurimit me elemente mjedisore ose sociale të përdorura				

indikatorit si dhe paraqitja e formulës së llogaritjes së indikatorit	(specifikimet teknike, kriteret e dhënies së kontratës, kushtet e kontratës) krahasuar me një vit më parë $\text{Mjedisore/Sociale} = \frac{\text{Numri i procedurave me elementë mjedisorë dhe sociale}}{\text{Numri total i procedurave}} \times 100$				
Informacion mbi vlerën bazë	Viti: 2023				
	Vlera bazë N/A Vlera e synuar: Trend rritës				
Informacion mbi vlerën e synuar	Viti:	2024	2025	2026	2027
	Vlera e treguesve				

TITULLI I INDIKATORIT	6. RRIJTJA E EFICIENCËS SË SISTEMIT TË ANKESAVE NËPËRMJET RRIJTJES SË SHPEJTTËSISË NË VENDIMMARRJE				
Objektivi përkatës	Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 QËLLIMI I POLITIKËS 3 – INTEGRITETI DHE LIGJSHMËRIA E PROCESIT TË PROKURIMEVE PUBLIKE				
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Sistemi i Shqyrtimit të Ankesave Analiza vjetore				
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Komisioni i Prokurimit Publik				
Indikatori dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.	PO				
Frekuenca e publikimit të të dhënave	Vjetor				
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë së indikatorit si dhe paraqitja e formulës së llogaritjes së indikatorit	Ndikimi do të vlerësohet duke matur numrin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit të parashikuar në ligj mbi numrin e ankesave totale të depozituara pranë KPP-së në një vit. $\text{SH. Shqyrtimitë} = \frac{\text{Numri i ankesave të shqyrtuara jashtë afatit}}{\text{Numri total i ankesave të depozituara pranë KPP në vit}} \times 100$				
Informacion mbi vlerën bazë	Viti: 2023				
	Viti 2023: Vlera 9.4% Vlera e synuar: Trend zbritës				
Informacion mbi vlerën e synuar	Viti:	2024	2025	2026	2027
	Vlera e treguesve				